



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti


Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI


PËR SHQIPËRINË 2014

Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND





BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK



GENZURA PLUS
SHËRBATA ZA PROMOCIJE I LUDROSHI
PRAVA I LUDROSHI I LUDROSHI
ASSOCIATION FOR PROMOTION OF
HUMAN RIGHTS AND MEDIA FREEDOM



Centar
za razvoj nevladinih
organizacija



TÜSEV
Türkiye Üçüncü Sektör Vakfı
Third Sector Foundation of Turkey



CPCD
Centar za promociju civilnog društva

Civic
Initiatives



VESTA



KICSIF
Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile



Opinionen by Association - Annonis
Opinionen by Association - Annonis
Opinionen by Association - Annonis

Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike

Fuqizimi i Advokacisë,

Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve

Matrica e Monitorimit

mbi Mjedisin Mundësues për
Zhvillimin e Shoqërisë Civile

RAPORTI

PËR SHQIPËRINË 2014



Projekti financohet nga:
Bashkimi Evropian



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**



“Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, dhe Olof Palme International Center në Shqipëri nëpërmjet financimit të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Bashkimit Evropian, Olof Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze.”

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit "Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike-Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve" dhe "Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave"

Partner kryesor:

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)

Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2
1000-Shkup
Maqedoni
Tel.: + 389 (0)2 614 42 11
E-mail: executiveoffice@balkancsd.net
Website: www.balkancsd.net

Partner zbatues në Shqipëri:

Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Rruga Sulejman Delvina, N.18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,
Kutia Postare (PO Box) 2418/1
Tel.: +355 4 2254881 Fax: +355 4 2254883
Email: partners@partnersalbania.org
<http://www.partnersalbania.org>

Botuar në Shqipëri, në Shkurt 2015

Drejtuese

Juliana Hoxha

Grupi i Vëzhgimit

Klotilda Tavani Kosta

Adela Bani

Maris Selamaj

Grupi i Administrimit të të Dhënave

Elona Kapexhiu

Grupi i Analizimit të të Dhënave dhe Hartimit të Raportit

Juliana Hoxha

Klotilda Tavani Kosta

Kostandina Keruti

ISBN: 978-9928-08-178-0

Dizajni grafik:



Arben Hamzallari

Printimi:

SHTËPIA BOTUESE
mediaprint



Partnerët Shqipëri
Qendra për Ndryshim
dhe Manaxhim Konflikti

Përmbajtja

I. Përmbledhja ekzekutive	6
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri.....	6
Gjetjet Kryesore	7
Rekomandimet Kryesore Politike.....	8
Rreth projektit dhe Matricës	10
II. Hyrje	12
Rreth Raportit të Monitorimit	12
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZSHHC) në Shqipëri	12
Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri	13
Mirënjohje dhe falenderime.....	15
III. Metodologjia	16
Përmbledhje e përqsjes metodologjike.....	16
Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve	17
IV. Gjetje dhe Rekomandime	19
Fusha 1: Garancitë Themelore Juridike të Lirive.....	19
Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të	22
Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC.....	31
V. Gjetjet dhe Rekomandimet (Tabela)	37
VI. Burimet e Përdorura dhe Lidhje të Dobishme në Internet	57
VII. Shtojca 1 Pyetësori për OSHC-të	56

I. Përmbledhja ekzekutive

Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile në Shqipëri

Në Shqipëri, liria e organizimit është e siguar dhe e garantuar me ligj. Individët dhe entitetet ligjore mund të themelojnë, të bashkohen dhe të marrin pjesë lirisht në organizatat e regjistruara dhe/apo jo - formale pa diskriminim. Zhvillimi i shoqërisë civile dhe Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) ka qenë i lidhur me nisma dhe ndryshime ligjore për të krijuar një mjedis mundësues për OSHC-të. Viti 2014 shënoi disa ndryshime pozitive dhe përmirësime në lidhje me mjedisin ligjor dhe rregullator për zhvillimin e shoqërisë civile, si dhe një perceptim më të mirë të OSHC-ve në lidhje me qëndrimin e shtetit ndaj nevojave të tyre dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Ndryshimet ligjore ndoqën angazhimet e shtetit që rrjedhin nga dhënia e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, në qershor 2014; vlerësimet dhe rekomandimet e bëra në Progres Raportin e fundit për Shqipërinë nga Komisioni Evropian në tetor 2014, si dhe angazhimi i bërë nga qeveria shqiptare në konferencën kombëtare "Partnerë Socialë - Koha për Veprim", organizuar nga Partnerët Shqipëri në muajin dhjetor 2013. Ndryshimet janë rezultat i lobimit dhe presionit të vazhdueshëm të OSHC-ve drejt përmirësimeve të kuadrit ligjor si dhe një ndërgjegjësim më i lartë i institucioneve publike mbi rolin dhe rëndësinë e OSHC-ve në demokratizimin dhe procesin e integritimit Evropian të vendit.

Për t'u theksuar është miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i Rezolutës për Njohjen dhe Forcimin

e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimeve Demokratike të Vendit, në 24 dhjetor 2014; përgatitja e projekt-ligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile; përgatitja e draftit të Udhërrëfyesit të Politikave të Qeverisë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile; miratimi i ligjit të ri të TVSH-së; miratimi i ligjit mbi Njohimin dhe Konsultimin Publik; miratimi i ligjit të ri Mbi të Drejtën e Informimit; përgatitja e Projekt Manualit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimarrës nga Kuvendi i Shqipërisë; dhe një qasje e hapur dhe me pjesëmarrje e ndjekur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) për të përcaktuar strategjinë dhe fushat e financimit të saj.

Ndërsa këto hapa thelbësore legjislative janë ndërmarrë në të gjitha fushat, sfidat kryesore nga 2013 mbeten kuadri për qëndrueshmërinë dhe lehtësirat financiare të OSHC-ve, trajtimi dhe rregulloret tatimore, fonde të pamjaftueshme publike që mbështesin aktivitetet dhe shërbimet e OSHC-ve, mungesa e procedurave mundësuese dhe transparente të prokurimit publik, efektiviteti i kuadrit të ri ligjor për konsultim publik që hyri në fuqi në gjysmën e dytë të 2014, dhe mungesa e transparencës së aktiviteteve të AMSHC-së. Gjithashtu, një çështje problematike mbetet mungesa e të dhënave zyrtare mbi numrin e OSHC-ve, numrin e të punësuarve (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe vullnetarëve në OSHC, si dhe mbi vlerën ekonomike të OSHC-ve në vend.

Gjetjet Kryesore

Gjetjet kryesore nga Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile adresojnë gjetjet më të rëndësishme mbi monitorimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi dhe impaktit në praktikë gjatë zbatimit të tyre. Në përgjithësi, kuadri ligjor për krijimin dhe regjistrimin e OSHC-ve është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe garanton të drejtën e tyre për të vepruar lirisht dhe pa ndërhyrje të pajustificuar të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme. Kuadri ligjor garanton dhe lejon OSHC-të të sigurojnë të ardhura financiare nga burime të ndryshme financimi si dhe të ushtrojnë aktivitet ekonomik për të siguruar qëndrueshmëri financiare. Një zhvillim i rëndësishëm në këtë fushë është miratimi i ligjit të ri të TVSH-së gjatë 2014 dhe qartësimi i "aktivitetit ekonomik" në ligj.

Në lidhje me mbështetjen e shtetit përmes fondeve publike, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është i vetmi entitet publik që targeton specifikisht OSHC-të, nëpërmjet shpërndarjes së fondeve publike përmes skemës së granteve. Gjatë 2014, me një Bord Mbikqyrës të ri të zgjedhur dhe Drejtor Ekzekutiv të ri të emëruar, AMSHC ka ndjekur një përjasje më të hapur me OSHC-të, duke realizuar një seri takimesh konsultuese për Strategjinë Afat-mesme dhe Afat-gjatë të saj, si dhe ka marrë pjesë në nisma të rëndësishme për sektorin siç është krijimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Gjithsesi, OSHC-të nuk janë të kënaqura me transparencën dhe llogaridhënien gjatë procesit të selektimit të OSHC-ve fituese dhe me rregullat e konfliktit të interesit që respektohen pjesërisht në praktikë.

Gjatë 2014, një zhvillim i rëndësishëm është përmirësimi i bashkëpunimit midis qeverisë dhe OSHC-ve. Progres i rëndësishëm është bërë në materializimin e dy çështjeve strategjike që do të kontribuojnë në institucionalizimin e bashkëpunimit midis shtetit dhe OSHC-ve: miratimi i Rezolutës për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimeve Demokratike të Vendit nga Kuvendi i Shqipërisë dhe përgatitja e projektligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, një organ këshillues, i pavarur pranë Këshillit të Ministrave. Përveç këtyre, gjatë vitit 2014 në konsultim me OSHC-të u përgatit Udhërrëfyesi (Road Map) i Politikave të Qeverisë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, i cili do të shërbejë si një dokument strategjik për bashkëpunimin dhe forcimin e dialogut mes qeverisë dhe shoqërisë civile. Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, i miratuar në 2014, parashikon detyrimin e organizimit të proceseve konsultuese me publikun për projektligjet dhe politikat. Në tërësi, ligji është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe institucionalizon konsultimin publik në hartimin dhe miratimin e projekt ligjeve, strategjive kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik, me synim përmirësimin e cilësisë së politikave dhe akteve ligjore në përgjithësi. Sipas legjislacionit ekzistues në vend, OSHC-të mund të konkurrojnë për kontrata shtetërore në ofrimin e shërbimeve të ndryshme nëpërmjet financimit publik. Megjithatë, kuadri ligjor që rregullon prokurimin publik nuk është mbështetës dhe krijon shumë pengesa që e bëjnë të pamundur për OSHC-të të konkurrojnë për kontratat shtetërore me të njëjtat kritere si ofruesit e tjerë të shërbimeve.

Nr.	6 gjetjet më kryesore të studimit	Referenca	
		Fusha	1
1	Nuk ka ndërhyrje të shtetit në qeverisjen e brendshme të OSHC-ve dhe nuk ka praktika të kontrollit të tepruar nga ana e shtetit.	Fusha	1
		Nën-Fusha	1.1
2	Aktiviteti ekonomik i OSHC-ve është qartësuar me ndryshimet që i janë bërë ligjit të OJF-ve (Ligji nr. 92/2013), ligjit mbi TVSH (Ligji nr.92/2014), dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.1
3	AMSHC ka zhvilluar një dialog të hapur me sektorin e shoqërisë civile, gjithsesi çështjet e transparencës dhe llogaridhënies në shpërndarjen e fondeve dhe konflikti i interesit brenda agjencisë mbeten problematike.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.2
4	Ka rritje të bashkëpunimit midis shtetit dhe OSHC-ve në përgatitjen e dokumentave strategjikë dhe në ngritjen e mekanizmave për krijimin e një mjedisi mundësues për OSHC-të dhe zhvillimin e shoqërisë civile.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.1
5	Ligji i ri mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik, që institucionalizon konsultimin publik në përgatitjen dhe miratimin e projektligjeve, strategjive kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik, u miratua nga Parlamenti Shqiptar në tetor 2014.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.2
6	Kudri ligjor nuk është mbështetës për përfshirjen e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve përmes fondeve publike.	Fusha	3
		Nën-Fusha	3.3

Rekomandimet Kryesore Politike

Rekomandimet kryesore politike janë bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe në eksperiencën e OSHC-ve dhe adresojnë rekomandimet kryesore politike për krijimin e një mjedisi mundësues për OSHC-të në Shqipëri dhe zhvillimin e shoqërisë civile në përgjithësi.

Kështu, një nga rekomandimet më të rëndësishme mbetet miratimi i raportimit financiar (përfshirë rregulloret mbi pastrimin e parave) dhe rregullat e kontabilitetit, të cilat marrin në konsideratë natyrën specifike të OSHC-ve, madhësinë dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve nga autoritetet tatimore. Deri më tani, raportimi financiar dhe rregullat e kontabilitetit nuk janë efektive për OSHC-të. Ligji “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” nuk ka specifikime dhe forma të diferencuara mbi pasqyrat financiare dhe raportimin e OSHC-ve nga ato të bizneseve dhe rregullat janë të njëjta për të gjitha OSHC-të, duke mos ndjekur parimin e proporcionalitetit.

Të gjitha raportimet financiare të përgatitura nga OSHC-të janë objekt kontrolli nga organet tatimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Parave, bazuar në vlerësimet e inspektorëve tatimor që nuk kanë njohuri mbi sektorin e OSHC-ve. Kështu, një tjetër rekomandim është përmirësimi i kësaj situate përmes rritjes së kapaciteteve të inspektorëve të taksave mbi kuadrin e ri ligjor tatimor që ndikon mbi OSHC-të dhe miratimi i procedurave të qarta të inspektimit tatimor.

Bazuar në gjetjet kryesore, një nga rekomandimet lidhet me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Sikundër transparenca dhe konflikti i interesit mbeten çështje shqetësuese për OSHC-të, është e nevojshme rritja e transparencës dhe llogaridhënies së AMSHC-së në shpërndarjen e fondeve dhe programeve të përshtatshme për t’iu përgjigjur nevojave të OSHC-ve. Gjithashtu, AMSHC duhet të miratojë procedura të qarta për të adresuar çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje, me synim sigurimin e një procesi

të drejtë përzgjedhjeje të OSHC-ve fituese të fondeve publike.

Një çështje tjetër që duhet të adresohet është mungesa e të dhënave statistikore mbi numrin dhe vlerën ekonomike të OSHC-ve. Shqipëria nuk ka të dhëna zyrtare nga Gjykata e Shkallës së Parë të Tiranës (autoriteti i vetëm shtetëror i ngarkuar për regjistrimin e OSHC-ve në Shqipëri) mbi numrin e përgjithshëm të OSHC-ve. Përveç kësaj, nuk ka informacion mbi numrin e punonjësve me kohë të plotë, numrin e punonjësve me kohë të pjesshme, numrin e vullnetarëve si dhe ndikimin ekonomik që kanë OSHC-të në vend. Të dhëna të tilla do të ndihmojnë shtetin për të kuptuar rëndësinë dhe rolin e sektorit në ekonominë e vendit, si dhe

për të hartuar programe dhe të ofrojë stimuj për të nxitur punësimin në sektorin e OSHC-ve. Shqipëria nuk ka një ligj të veçantë që rregullon çështjen e vullnetarizmit, pavarësisht rolit të domosdoshëm dhe kontributit të vullnetarëve ndër vite në kryerjen e aktiviteteve të shumta të OSHC-ve. Miratimi i një kuadri të veçantë ligjor mbi vullnetarizmin do të inkurajojë në mënyrë proaktive zhvillimin e tij dhe do të ofrojë përfitime për shoqërinë.

Duke marrë parasysh situatën problematike përse i përket pjesëmarrjes së OSHC-ve në prokurimin publik për ofrimin e shërbimeve, një nga rekomandimet kryesore mbetet miratimi i një ligji të veçantë mbi prokurimin social, i ndarë nga ligji i prokurimit publik.

Nr.	6 rekomandimet më të rëndësishme për reformë	Referenca	
1	Miratimi i rregullave të raportimit financiar (përfshirë rregulloret mbi pastrimin e parave) dhe të kontabilitetit, të cilat marrin në konsideratë natyrën specifike, madhësinë dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të OSHC-ve nga autoritetet tatimore.	Fusha	1
		Nën-Fusha	1.1
2	Rritja e kapaciteteve të inspektorëve tatimore mbi kuadrin e ri ligjor tatimor që ndikon tek OSHC-të dhe miratimi i procedurave të qarta të inspektimit tatimor.	Fusha	1
		Nën-Fusha	1.2
3	Nevojiten të dhëna statistikore publike mbi numrin dhe vlerën ekonomike të OSHC-ve në vend.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.2
4	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së AMSHC-së në shpërndarjen e fondeve dhe programim i përshtatshëm për t'iu përgjigjur nevojave të sektorit të OSHC-ve. Miratimi i procedurave të qarta për të adresuar çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.2
5	Miratimi i ligjit mbi vullnetarizmin.	Fusha	2
		Nën-Fusha	2.3
6	Miratimi i një ligji të veçantë për prokurimin social.	Fusha	3
			3.3

Rreth projektit dhe Matricës

Ky raport monitorimi është pjesë e aktiviteteve të “Acquis e Shoqërisë Civile në Ballkan - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve” projekt i financuar nga BE dhe Balkan Trust for Democracy (BTD), dhe projektit “Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave”, financuar nga Olof Palme International Center me fonde të qeverisë Suedeze. Ky Raport Monitorimi është i pari i llojit të tij që do të publikohet në baza vjetore, të paktën gjatë kohëzgjatjes 48 mujore të projektit. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZSHSC) zhvilluar nga BCSDN dhe ECNL. Ajo është pjesë e një serie raportimesh vendore që përfshin tetë (8) vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë¹. Një Raport Rajonal Monitorimi është i gjithashtu i disponueshëm, i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve si edhe një platformë web-i që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave tek www.monitoringmatrix.net.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standartet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimet e OSHC-ve. Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha: (1) Garancitë Themelore Juridike të Lirive; (2) Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të; (3) Marrëdhënia Qeveri-OSHC. Parimet, standartet dhe indikatorët janë formuluar duke marrë në konsideratë stadin e zhvillimit dhe

diversitetin e vendeve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi. Ato mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara në mënyrë ndërkombëtare dhe në praktikën rregullatore më të mira në nivelin e Bashkimit Evropian dhe të vendeve të Evropës. Matrica synon të përcaktojë një situatë optimale të dëshiruar për shoqërinë civile që ajo të funksionojë e të zhvillohet në mënyrë efektive dhe synon gjithashtu të vendosë një kuadër realist i cili të mund të ndiqet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke patur parasysh se sfidat kryesore qëndrojnë kryesisht në zbatim, indikatorët janë përcaktuar për të monitoruar situatën në nivelin e kuadrit ligjor dhe aplikimit praktik të tij. Raporti i monitorimit dhe raportimit në vitin 2014 është fokusuar në dymbëdhjetë (12) standarte kryesore që u monitoruan në të gjitha vendet dhe pesë (5) standarte të përzgjedhura për t'u monitoruar në Shqipëri, bazuar në ndryshimet e pritura në Fushën e 3-të të Matricës së Monitorimit: Marrëdhënia Qeveri – OSHC. Dymbëdhjetë standartet janë si vijon: Standarti 1.1.2 OSHC-të veprojnë lirisht, pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen e brendshme dhe aktivitete e tyre; Standarti: OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, burime financiare për të mbështetur aktivitetet e tyre; Standarti 1.2.1 Përfaqësuesit e OSHC-ve individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore; Standarti 2.1.1 Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve; Standarti 2.2.1 Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve,

1) Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali I Zi, Serbia and Turqia.

mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e BE dhe granteve të tjera; Standarti 2.2.2 Financimi publik jepet në një mënyrë të paracaktuar dhe transparente; Standarti 2.3.1 OSHC-të trajtohen në një mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë; Standarti 2.3.2 Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin; Standarti 3.1.2 Shteti njeh, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të; Standarti 3.2.1 Ekzistojnë standarte që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendim-marrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur; Standarti 3.2.3 Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutime në organet ndër-sektoriale dhe janë zgjedhur nëpërmjet kriterëve dhe proceseve të përcaktuara qartë; Standarti 3.3.1 OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe

konkurrojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë. Pesë (5) standartet e tjera të përzgjedhura, që janë monitoruar në Shqipëri janë si vijon: Standarti 3.1.1 Shteti njeh, përmes strategjive dhe politikave, rëndësinë e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin; Standarti 3.2.2 Të gjitha projekt ligjet dhe politikat janë lehtësisht të qasshme për publikun në kohën e duhur; Standarti 3.3.2 Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afat-gjatë; Standarti 3.3.3 Shteti ka përcaktuar procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë përzgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHC-të; Standarti 3.3.4 Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve.

II. Hyrje

Rreth Raportit të Monitorimit

S i pjesë e nismës “Acquis e Shoqërisë Civile në Ballkan - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve”, dhe “Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave” Partnerët Shqipëri realizoi për të dytin vit rradhazi vëzhgimin që rezultoi me Raportin e Matricës të Monitorimit 2014. Vëzhgimi u realizua gjatë periudhës shtator – nëntor 2014. Ky raport monitorimi synon të japë një pasqyrë të çështjeve që lidhen me mjedisin mundësues të OSHC-ve në Shqipëri si dhe rekomandime se si këto çështje mund të adresohen dhe të zgjidhen. Këtë vit raporti u fokusua në dymbëdhjetë (12) standarte kryesore dhe pesë standarte (5) të përzgjedhura. Standardet e përzgjedhura i përkasin fushës së tretë të Matricës së Monitorimit (MM): Marrëdhënia Qeveri - OSHC dhe u konsideruan të rëndësishme për tu monitoruar pasi konsistonin në angazhimet e ndermarra nga qeveria Shqiptare në konferencën kombëtare “Partnerë Social – Koha për Veprim” organizuar nga Partnerët Shqipëri në dhjetor 2013².

Raporti i Matricës së Monitorimit 2014, i përgatitur nga Partnerët Shqipëri, bazohet në një hulumtim të legjislacionit shqiptar, politikave, studimeve dhe raporteve të përdorura për të vlerësuar indikatorët ligjorë të Matricës së Monitorimit, si dhe vëzhgim dhe intervista të thelluara me përfaqësues të OSHC-ve, të përdorura për të vlerësuar indikatorët praktikë të Matricës³.

Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Ky Raport Monitorimi është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis e Shoqërisë Civile në Ballkan - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OSHC-ve” financuar nga BE dhe nga Balkan

Trust for Democracy (BTD), dhe projektit “Rritja e Pjesëmarrjes Qytetare në Hartimin dhe Zbatimin e Politikave”, financuar nga Olof Palme International Center me fonde të qeverisë Suedeze. Ky Raport Monitorimi është i pari i llojit të tij që do të publikohet në baza vjetore, të paktën gjatë kohëzgjatjes 48 mujore të projektit. Monitorimi bazohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (ZHSHC) hartuar nga BCSDN dhe ECNL. Ajo është pjesë e një serie raportimesh vendore që përfshin 8 vende në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë⁴. Një Raport Rajonal Monitorimi është gjithashtu i disponueshëm, i cili përmbledh të dhënat dhe rekomandimet e të gjitha vendeve si edhe një platformë web-i që ofron akses në të dhënat e monitoruara sipas vendeve dhe nën-fushave tek www.monitoringmatrix.net.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është fuqizimi i bazave për monitorimin dhe advokacinë mbi çështjet e lidhura me mjedisin mundësues dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile në nivel rajonal dhe vendor si edhe fuqizimi i strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OSHC-ve në politikat e BE dhe procesin e integritimit në nivel Evropian dhe vendor.

2) <http://www.partnersalbania.org/?fq=brenda&m=news&gj=gj1&lid=110>

3) http://monitoringmatrix.net/wp-content/uploads/2014/04/BCSDN_Monitoring_Matrix-tool-kit.pdf

4) Shqipëria, Bosnja dhe Herzegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali I Zi, Serbia and Turqia.

Matrica është e organizuar në tre fusha, e ndarë secila në nën-fusha:

1. Garancitë Themelore Juridike të Lirive;
2. Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të;
3. Marrëdhënia Qeveri-OSHC.

Matrica e Monitorimit prezanton parimet dhe standartet kryesore, ekzistenca e të cilave është thelbësore në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet mbështetës dhe mundësues për veprimet e OSHC-ve. Ajo nënvizon faktin se mjedisi mundësues

është një koncept kompleks, i cili përfshin fusha të ndryshme dhe varet nga faktorë të ndryshëm dhe nga fazat e zhvillimit të shoqërisë dhe të sektorit të shoqërisë civile.

Kjo Matricë nuk synon të përfshijë të gjitha çështjet e mjedisit mundësues. Ajo thekson më tepër ato që ekspertët kanë përcaktuar si më të rëndësishme për vendet në të cilat ata kanë kryer veprimtarinë e tyre. Prandaj, standartet janë formuluar duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të zhvillimit dhe diversitetin në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ato janë hartuar nga eksperiencat e OSHC-ve të këtyre vendeve në termat e mjedisit ligjor si edhe praktikës e sfidave në zbatimin e tij. Zhvillimi i parimeve, standarteve dhe indikatorëve është realizuar duke marrë në konsideratë liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht si edhe praktikën më të mira në Bashkimin Evropian dhe në vendet e Evropës.

Fushat janë përcaktuar sipas parimeve kryesore të cilat zhvillohen më tej sipas standardeve specifike. Nga ana e tyre, standartet shpjegohen më tej përmes indikatorëve, në mënyrë që t'i japin OSHC-ve lokale, donatorëve apo palëve të tjera të interesuara mundësinë për të parë e monitoruar mjedisin ligjor dhe praktikën e aplikimit të tij.

Përpunimi i Matricës së Monitorimit mbi mjedisin mundësues për ZHSHC-në, ishte pjesë e një përpjekje të përbashkët të ekspertëve të OSHC-ve dhe praktikuesve nga rrjeti i anëtarëve

e partnerëve të BCSDN dhe me ekspertë e mbështetje strategjike nga ECNL. Ekipi me 11 anëtarë ekspertë përfshiu një mori njohurish e eksperiencash nga OSHC dhe organizata jo-fitimprurëse, si ligjore ashtu edhe praktike, dhe përfshiu ekspertë nga 10 vende të Ballkanit. Puna me Matricën përfshiu takimet e punës si edhe punën on-line nga ekspertët, e cila u shqyrtua më tej nëpërmjet fokus-grupeve të aktorëve si edhe konsultimeve publike. Puna për zhvillimin e Matricës u mbështet nga USAID, Pact. Inc, dhe ICNL brenda Programit të Mjedisit Mundësues Ligjor (LEEP)/Grantit të Inovacionit Ligjor dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZHSHC) në Shqipëri

Gjatë dy dekadave të fundit, zhvillimi i shoqërisë civile në Shqipëri ka qenë i lidhur me ndryshime të mëdha ligjore dhe institucionale që tentuan të krijojnë një mjedis mundësues për OSHC-të. Vitet 1990-të shënuan një rritje të shpejtë të sektorit të OSHC-ve me fundin e sundimit totalitar dhe kalimit në demokraci. Shoqëria civile u zhvillua njëkohësisht me krijimin dhe zhvillimin e sektorit privat dhe ekonomisë së tregut të lirë, si një element kryesor për funksionimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë në vend.

Ka përafërsisht 8,449 OSHC të regjistruara në Shqipëri⁵. Bazuar në formën e tyre të regjistrimit⁶, ato ndahen në 6,263 shoqata, 846 fondacione, 1095 qendra dhe 245 janë përfshirë në kategorinë “tjetër”⁷. Gjithsesi nuk ka të dhëna statistikore zyrtare, në dispozicion të publikut, mbi numrin dhe vlerën ekonomike të OSHC-ve në vend, dhe nuk ka të dhëna zyrtare të qarta se sa nga këto janë ende aktive, apo janë ri-regjistruar sipas Ligjit nr. 8788, datë 7 maj 2001, Për Organizatat Jo-fitimprurëse. Referuar projektit open.data.al⁸, ka një rritje të numrit të OSHC-ve aktive nga 794 OSHC në 2005 në 2110 OSHC në 2013. Këto të dhëna tregojnë se mesatarisht ka 170 organizata të reja të regjistruara në vit nga 2005

5) Të dhënat janë marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë, përmes një kërkesë të paraqitur nga Partnerët Shqipëri në prill 2014.

6) Ligj nr. 8788, datë 7 maj 2001 Mbi Organizatat Jo-fitimprurëse, neni 10 dhe neni 11.

7) Kategoria “tjetër” përfshin organizata që kanë emërtime të ndryshme nga fondacione, shoqata dhe qendra. Kjo përfshin: Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, federatat, unionet, institutet, agjencitë, komitetet, person juridik, grupe, klube, lëvizje, forume apo dhe ato që nuk kanë një përkufizim specifik që lidhet me emrin e tyre si Kryqi i Kuq Shqiptar.

– 2013, me numrin më të lartë të organizatave të regjistruara në 2013, respektivisht 254 OSHC⁸⁾. Të dhënat e siguruar nga open.data.al mbeten të diskutueshme, pasi ato reflektojnë vetëm OSHC-të e regjistruara në organet tatimore, ndërkohë që jo të gjitha OSHC-të detyrimisht regjistrohen në organet tatimore deri në momentin që ato përfitojnë një grant dhe / ose u kërkohet nga donatori.

Përgjatë viteve, kuadri ligjor dhe rregullator për OSHC-të ka qenë subjekt i ndryshimeve. Kuadri ligjor për krijimin dhe regjistrimin e OSHC-ve është favorizues dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare. Kuadri ligjor mbi trajtimin tatimor të OSHC-ve mbetet një nga sfidat kryesore që nevojitet të adresohet, pavarësisht ndryshimeve të fundit dhe kuadrit ligjor të miratuar në fund të vitit 2014, i cili sjell qartësi për sa i përket aktivitetit ekonomik të OSHC-ve.

Ndryshimet në kuadrin ligjor janë shoqëruar me ngritje kapacitetesh dhe zhvillim institucional të OSHC-ve, të cilat kanë synuar të forcojnë rolin dhe kontributin e tyre në shoqëri, për të qenë partnere të barabarta me shtetin në zhvillimet strategjike të vendit. Konferenca kombëtare “Partnerë Socialë – Koha për Veprim” tregoi se një shoqëri civile e bashkuar mund të sjellë në tavolinë një diskutim të nivelit të lartë me qeverinë, si dhe zhvillimin e një platforme për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile të mirëpërgatitur dhe të prezantuar nga ekspertë të shoqërisë civile me eksperiencë. Rreth 130 përfaqësues të OSHC-ve në konferencën kombëtare diskutuan dhe dhanë rekomandimet e tyre për ndryshimet politike dhe ligjore rreth tre fushave të Matricës së Monitorimit: Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe vendim-marrje dhe mbështetjen e shtetit në këtë proces; Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile përmes një kuadri ligjor mundësues; Sektori i organizatave të shoqërisë civile si një partner social i shtetit në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe institucionet publike. Konferenca përfundoi në

një Deklaratë të përbashkët të Përfaqësuesve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri lidhur me institucionalizimin e marrëdhënies midis qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile dhe avancimin e kuadrit ligjor mbi disa çështje urgjente për OSHC-të. Deklarata iu prezantua Zëvendëskryeministrit Z. Niko Peleshi, në prezencë të SH.T.Z. Aleksandër Arvizu, Ambasador i SHBA në Shqipëri, Sh.T.Z. Ettore Sequi, Kreu i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, anëtarë të Kuvendit të Shqipërisë dhe qeverisë, përfaqësues të komunitetit donator, organizatave lokale dhe ndërkombëtare. Duke njohur rolin e pazëvendësueshëm të OSHC-ve në forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, Z. Peleshi theksoi angazhimin e qeverisë për ndërtimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me shoqërinë civile dhe ngritjen e tij në një nivel më të lartë. Konferenca vendosi bazat e një dialogu zyrtar me qeverinë e re për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile për avancimin e shoqërisë civile si një partner social dhe pjesë integrale e proceseve të hartimit të politikave dhe vendim-marrjeve në vend. Si rezultat i këtij dialogu, në 2014 filloi përgatitja e dokumentave strategjikë dhe krijimi i mekanizmave që do të mundësojnë institucionalizimin e mëtejshëm të këtij partneriteti.

Ekzistenca e një shoqërie civile aktive dhe të fortë është konsideruar një faktor kyç për Shqipërinë në procesin e Integritimit Evropian. Pas marrjes të statusit të vendit kandidat për në BE, në qershor 2014, ekspertët e shoqërisë civile janë përfshirë në çdo fazë të procesit konsultues, i konsideruar nga Bashkimi Evropian si një burim i vlefshëm ekspertize për vlerësimin e zhvillimeve në fushat e tyre të angazhimit. Nga ana tjetër, pas vitesh stanjacioni, dhe regresi në disa dimensione për sa i përket bashkëpunimit midis shtetit dhe shoqërisë civile, shteti ka nisur të aplikojë një përjasje më të hapur dhe bashkëpunuese me shoqërinë civile në përgatitjen e ligjeve të reja, akteve nënligjore, strategjive dhe dokumentave politikë të tjerë mbështetëse në procesin e integritimit të vendit.

8) Open.data.al është një projekt i Institutit Shqiptar të Shkencës. Qëllimi i projektit është të mbledhë dhe ruajë të dhëna mbi indikatorët socio-ekonomik të vendit.
9) <http://open.data.al/en/lajme/lajm/lang/en/id/1186/Tregues-statistikor-per-Organizata-Jofitimprures-2005-2013>

Karakteristika dhe sfida specifike në aplikimin e Matricës në Shqipëri

Që nga shpallja e ciklit të monitorimit në 2013, Partnerët Shqipëri synoi një proces gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje të gjerë për të përgatitur raportin e monitorimit, duke prezantuar dhe diskutuar Matricën me një numër të madh organizatash në të gjithë vendin. Këtë vit vëzhgimi për të përgatitur raportin e monitorimit u realizua në 12 qytete dhe 180 OSHC u kontaktuan për të dhënë kontributin e tyre për raportin e MM, 100 prej të cilave iu përgjigjën vëzhgimit.

Pyetëtori i përgatitur për vëzhgimin përfshiu pyetje për 17 nga 24 standarte të Matricës, duke çuar në reduktim të pyetjeve krahasuar me vëzhgimin për përgatitjen e raportit të MM 2013. Kjo kontribuoi në një analizë më të thelluar monitorimi për çështjet e përzgjedhura.

Një karakteristikë specifike e procesit të monitorimit gjatë 2014 ishte diskutimi i gjetjeve paraprake në gjashtë qytete (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, dhe Korçë) me 101 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Diskutimet pasuruan gjetjet e raportit të monitorimit.

Një sfidë kryesore për kryerjen e vëzhgimit me sektorin e OSHC-ve në Shqipëri mbetet mungesa e të dhënave zyrtare mbi OSHC-të (numri i OSHC-ve, forma e regjistrimit, shpërndarja gjeografike, raporti sipas fushës së tyre të aktiviteteve, etj.). Kjo situatë vështirëson grumbullimin e të dhënave dhe analizën e tyre si dhe kërkon kohë për përgatitjen e saj.

Intesiteti i punës në një afat kohor të limituar ishte një sfidë tjetër për grupin e vëzhgimit të përfshirë

në administrimin e pyetësorit.

Për hir të kompleksitetit të çështjeve të trajtuara në pyetësor, pyetëtori u plotësua nga drejtorët ekzekutivë të OSHC-ve përmes intervistave ballë për ballë ose me telefon, duke synuar mbledhjen e të dhënave të nevojshme. Pyetëtori u pasua nga intervista të thelluara për të eksploruar çështjet kontradiktore apo fushat ku për hir të qëllimeve të analizës nevojitej më tepër informacion.

Një sfidë tjetër ishte vështirësia për të gjetur informacion të saktë dhe të përditësuar nga institucionet dhe autoritetet publike, përmes kanaleve të tyre të komunikimit, që do të mundësonin lehtësimin e hulumtimit mbi çështjet ligjore.

Mirënjohje dhe falenderime

Raporti i Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Organizatave të Shoqërisë Civile është përgatitur në bashkëpunim dhe me mbështetjen bujare të OSHC-ve, ekspertëve dhe individëve.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen drejtorëve ekzekutivë të përfshirë në këtë raport monitorimi duke vlerësuar bashkëpunimin, kontributin dhe kohën e përkushtuar. Kontributi i tyre i dha një vlerë të paçmuar përmbajtjes së raportit.

Partnerët Shqipëri dëshiron t'i shprehë mirënjohjen Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), Qendrës Evropiane për Ligjin Jofitimprurës dhe Olof Palme International Center në Shqipëri për mbështetjen në zhvillimin, orientimin dhe zbatimin e kësaj përpjekje monitoruese.

III. Metodologjia

Përmbledhje e përjasjes metodologjike

Procesi i MM (Matricës së Monitorimit) u realizua gjatë periudhës shtator – nëntor 2014. Partnerët Shqipëri përgatiti dhe përdori një set mjetesh metodologjike, duke përfshirë hulumtim literature së bashku me përjasjen me pjesëmarrje në sigurimin e të dhënave dhe informacionit me qëllimin e përgjithshëm për të monitoruar standartet në nivel legjislativ dhe praktik të MM. Qëllimi ishte identifikimi i progresit ose regresit të mjedisit mundësues duke përfshirë: klimën e përgjithshme, legjislacionin dhe efektivitetin e implementimit të tij për veprimtarinë e OSHC-ve në Shqipëri.

Në ndryshim nga procesi i monitorimit të 2013 ku të gjitha standartet u monitoruan, ky raport thekson gjetjet mbi 17 standarte në tre fushat e Matricës së Monitorimit.

Raporti i monitorimit u përgatit përmes fazave kërkimore si më poshtë:

1. Rishikim/Hulumtim literature

Duke marrë në konsideratë që Matrica përmban indikatorë rreth legjislacionit dhe praktikës hulumtimi i literaturës u realizua përmes:

- 1.1. *Rishikimit të kuadrit ligjor* – një hulumtim literature u krye për të vlerësuar kuadrin ligjor dhe rregulloret për një mjedis mundësues për OSHC-të. Ai përfshiu një rishikim dhe analizë të legjislacionit shqiptar (duke përfshirë vendimet rregulluese), si dhe analiza mbi zbatimin e konventave dhe

rregulloreve ndërkombëtare të miratuara nga Shqipëria.

- 1.2. *Rishikimit të praktikës bazuar në të dhëna dytësore* – një hulumtim literature u krye me qëllimin për të identifikuar: (i) raportet e OSHC-ve mbi vlerësimin e nevojave dhe implementimin e tyre (ii) raportet e mediave që mbulojnë zbatimin praktik (iii) raportet e organizatave ndërkombëtare dhe donatore dhe (iv) analizën e nevojave mbi fushat/ çështjet dhe raportet ndërkombëtare apo dokumentet krahasuese mbi çështjet.

2. Vëzhgimi

Vëzhgimi u realizua përmes administrimit të një pyetësori me 100 përfaqësues të OSHC-ve. Me qëllim krahasimin e të dhënave me vitin e mëparshëm, Partnerët Shqipëri përdori të njëjtin kampion si vitin e kaluar me disa ndryshime të vogla që përfshijnë: pjesëmarrjen e OSHC-ve të reja të regjistruara gjatë 2013 - 2014 dhe shtrirjen e shpërndarjes gjeografike të OSHC-ve nga tetë (8) qytete në 2013 në dymbëdhjetë (12) qytete në 2014. Pyetësori u realizua gjatë periudhës shtator – nëntor 2014 me drejtorët ekzekutivë të OSHC-ve përmes intervistave ballë për ballë dhe intervistave përmes telefonit. Ai ishte i ndarë në katër sesione kryesore: një sesion për çdo fushë të matricës dhe një session për të dhënat demografike të të intervistuarit dhe OSHC-së. Në pyetësor u përdor kombinimi i pyetjeve me alternativa me pyetje të hapura me qëllim mbledhjen e informacionit mbi perceptimin dhe përvojën e të intervistuarve mbi treguesit e monitoruar. Informacioni i mbledhur nga pyetësorët u përpunua dhe u analizua përmes

programit SPSS.

3. Intervista të thelluara

Partnerët Shqipëri realizuan intervista të thelluara me drejtorë ekzekutive të përzgjedhur të OSHC-ve, duke adresuar pyetje të lidhura me disa gjetje të studimit dhe marrjen e informacionit mbi ndryshimet në kuadrit ligjor për fusha specifike të raportit të MM.


Pjesëmarrja e komunitetit të OSHC-ve

Partnerët Shqipëri përdori databazën e saj për t'i informuar dhe ftuar OSHC-të të merrnin pjesë

në vëzhgim, me qëllim përgatitjen e raportit të Matricës së Monitorimit 2014. Të gjitha të dhënat mbi indikatorët e praktikës bazohen në informacionin dhe komentet e përfaqësuesve të OSHC-ve të intervistuar mbi zbatimin e kuadrit ligjor.

Vëzhgimi u realizua në 12 qytete. Përzgjedhja e kampionit u realizua në përputhje me numrin e OSHC-ve në çdo qytet, bazuar në databazën e Partnerëve Shqipëri. Grafiku 1 prezanton shpërndarjen gjeografike të organizatave që iu përgjigjën pyetësorit.


Grafiku 1. Shpërndarja gjeografike e OSHC-ve



Përsa i përket formës së regjistrimit, kampioni u përbë nga 57% shoqata, 24% qendra, 18% fondacione dhe 1% ndërmarrje sociale siç paraqitet në grafikun 2. Ndërmarrjet sociale nuk janë një formë regjistrimi e njohur nga legjislacioni

shqiptar, por kjo alternativë u përfshi në pyetësor duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit mbi përgatitjen dhe miratimin e ligjit mbi ndërmarrjet sociale dhe ushtrimin e veprimtarisë së disa OSHC-ve si ndërmarrje sociale.


Grafiku 2. Forma e regjistrimit të organizatave



Bazuar në përgjigjet e tyre me shumë alternativa, në grafikun 3 janë paraqitur fushat e veprimtarisë së OSHC-ve që marrin pjesë në vëzhgim dhe aktivitetet e tyre kryesore. Sikundër pasqyrohet në grafik ka

një dominim të OSHC-ve që punojnë në fushën e rinisë e kulturës, edukimit, ndjekur nga OSHC që punojnë në fushën e gruas, ndërsa ka një përfaqësim të ulët të OSHC-ve që punojnë në fushën e biznesit.

Grafiku 3. Fushat e aktivitetit të OSHC-ve



1. Mësimet e nxjerra

- Përqasja gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje e aplikuar siguroi një numër të gjerë pjesëmarrësish të OSHC-ve dhe pasqyroi zhvillimin e sektorit në të gjithë Shqipërinë (përpos hulumtimit).
- Matrica prezantoi një set standartesh gjithëpërfshirëse dhe komplekse dhe ilustrimi me shembuj ishte shumë i vlefshëm në përgatitjen e raportit të monitorimit.

IV. Gjetje dhe Rekomandime

Fusha 1: **Garancitë Themelore Juridike të Lirive**

Nën-fusha 1.1.: Liria e organizimit

Vlerësimi i kësaj nën-fushe bazohet në standardet e mëposhtme: Standarti 1: OSHC-të veprojnë lirisht, pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen e brendshme dhe aktivitetet e tyre; Standarti 2: OSHC-të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht nga burime të ndryshme vendase dhe të huaja, burime financiare për të mbështetur aktivitetet e tyre.


Liria e organizimit është një e drejtë kushtetuese për çdo individ dhe person juridik pa asnjë diskriminim mbi bazë moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie apo etnie. Në këtë kontekst, në vitin 2014 nuk ka ndryshime që do të mund të përmirësonin apo pengonin mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve në Shqipëri. Regjistrimi i OSHC-ve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës ende paraqet një barrierë dhe kosto shtesë për individët

dhe entitetet ligjore që synojnë të krijojnë një OSHC¹⁰.


Shteti garanton të drejtën e OSHC-ve për të rregulluar strukturën e tyre të brendshme dhe procedurat vepruese pa ndërhyrje të pajustificuara të tij në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme. Nuk ka praktika të ndërhyrjes së shtetit si: detyrimi i pjesëmarrjes së një përfaqësuesi shtetëror në bordin e OSHC-ve, miratim paraprak nga shteti për kryerjen e aktiviteteve të tyre, etj. Ndërsa nuk ka ndryshime në kuadrin ligjor nga viti 2013, perceptimi dhe eksperiencia e OSHC-ve lidhur me ndërhyrjen e shtetit dhe praktikave mbikqyrjeve okupuese nga ana e shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme është përmirësuar. Krahasuar me gjetjet e Raportit të MM 2013 ka një rritje prej 15% të organizatave të intervistuar, të cilat shprehen se nuk ka praktika të ndërhyrjes së shtetit në qeverisjen e brendshme, dhe një rritje prej 20% e OSHC-ve të intervistuar që kanë deklaruar se nuk ka praktika të mbikqyrjes okupuese nga ana e shtetit.

¹⁰⁾ http://www.partnersalbania.org/raporti_monitorimit_shqiperi.pdf 2013, fq. 17

Grafiku 4. Ndërhyrja e shtetit në qeverisjen e brendshme të OSHC-ve.



Grafiku 5. Ekzistenca e praktikave kontrolluese të shtetit.



Grafiku 4 tregon se 81% e OSHC-ve të intervistuar janë përgjigjur se “nuk ka aspak” ndërhyrje të shtetit në qeverisjen e brendshme të OSHC-ve dhe grafiku 5 tregon se 72% e OSHC-ve të intervistuar janë përgjigjur se “nuk ka aspak” praktika të mbikqyrjeve okupuese nga ana e shtetit. Ato organizata, të cilat janë përgjigjur se ka “shumë” ndërhyrje nga ana e shtetit në qeverisjen e tyre të brendshme (2% e OSHC-ve të intervistuar) dhe që ka “shumë” praktika të mbikqyrjeve okupuese nga ana e shtetit (5% e OSHC-ve të intervistuar), nuk dhanë shembuj nga eksperiencia e organizatës së tyre për ta ilustruar përgjigjen.

Ligji Nr. 9228, datë 29.04.2001 “Për Kontabilitetin

dhe Pasqyrat Financiare” dhe Ligji Nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për Inspektimin Financiar” janë ligjet kryesore që rregullojnë raportimin financiar të OSHC-ve. Gjatë 2014 këto ligje nuk janë ndryshuar. Raportimi financiar nuk është përshtatur me karakteristikat specifike të veprimtarisë së OSHC-ve dhe nuk është në përputhje me madhësinë e organizatës dhe llojin apo qëllimin e aktiviteteve të saj. Format e raportimit financiar dhe të kontabilitetit nuk ndryshojnë nga format e kontabilitetit dhe raportimit të bizneseve.

Me amendimet e bëra në Ligjin e OJF-ve¹¹, të gjitha raportimet financiare të përgatitura nga OSHC-të për fondet e donatorëve janë objekt kontrolli nga

11) Ligj nr.92/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 « mbi Organizatat Jo-fitimprurëse», i ndryshuar

organet tatimore, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, sa herë që është e nevojshme. Pas miratimit të ligjit "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit"¹² në 2008, kuadri ligjor dhe rregullator mbi OSHC-të është ndryshuar dhe zhvilluar për të adresuar këtë çështje. Me ndryshimet e fundit të ligjit të OJF-ve në 2013¹³, janë përfshirë detyra mbi organet vendim-marrëse dhe organin ekzekutiv në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë evazive dhe i ngarkojnë këto organe me përgjegjësi për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste dhe pastrim parash.

Më 19 nëntor 2014, Ministria e Financave lëshoi një udhëzim për mbikqyrjen e OSHC-ve nga autoritetet tatimore, në mbështetje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹⁴, për rregullimin e procedurave që ndiqen nga organet tatimore, për kontrollin e veprimtarisë së OJF-ve, me qëllim shmangien e mundësisë së përdorimit të tyre për pastrim parash apo financim terrorizmi. Udhëzimi parashikon një mbikqyrje të rreptë çdo gjashtë muaj për: 1) OJF që zhvillojnë aktivitet pa u regjistruar; 2) OJF me status pasiv; dhe 3) OJF që nuk dorëzojnë deklaratat tatimore sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi¹⁵.

Ligji parashikon që inspektorët tatimorë, të ngarkuar me mbikqyrjen e OSHC-ve, duhet të jenë të specializuar dhe trajnuar për shqyrtimin e pasqyrave financiare të OSHC-ve¹⁶, por praktika tregon që ka mungesë kapacitetesh të inspektorëve tatimore që analizojnë OSHC-të, dhe si rrjedhojë ka një nevojë urgjente për trajnimin e tyre me qëllim parandalimin e praktikave abuzuese dhe sigurimin e zbatimit korrekt të kuadrit ligjor mbi pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji për Organizatat Jofitimprurëse parashikon transformimin, bashkimin, ndërprerjen e veprimtarisë dhe shpërndarjen me iniciativën e saj dhe me vendim gjykatë.

Burimet e të ardhurave për një organizatë jofitimprurëse janë të ardhurat nga kuotizacioni kur ka të tilla, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse.¹⁷ Në çdo rast, ligji nuk përbën pengesë në lidhje me sigurimin e të ardhurave si nga burime brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.

Ndërsa nuk ka kufizime ligjore që ndalojnë OSHC-të të marrin fonde nga burime të ndryshme financimi, ka arsye praktike që e bëjnë të vështirë për OSHC-të të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht financime nga të gjitha burimet e të ardhurave. Fondet nga donatorët e huaj mbeten burimi kryesor për OSHC-të, të cilat kërkojnë dhe sigurojnë lirisht të ardhura financiare (63% e OSHC-ve të intervistuar janë shprehur që mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht fonde nga donatorë të huaj). Nga ana tjetër, është shumë e vështirë për OSHC-të që të kërkojnë dhe sigurojnë fonde publike, sikundër 69% e të intervistuarve janë shprehur se e kanë të vështirë të kërkojnë dhe sigurojnë fonde nga qeveria qendrore, 78% e OSHC-ve të intervistuar janë shprehur se e kanë të vështirë të kërkojnë dhe sigurojnë fonde nga qeveria vendore dhe 91% e OSHC-ve të intervistuar janë shprehur se e kanë të vështirë të kërkojnë dhe sigurojnë fonde nga prokurimi publik. Kjo situatë qëndron problematike dhe në krahasim me Raportin e MM 2013, numri i OSHC-ve, që e kanë të vështirë të kërkojnë dhe sigurojnë fonde nga shteti është rritur, veçanërisht nga prokurimi publik, ku pothuajse të gjitha OSHC-të kanë vlerësuar që nuk mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirisht fonde nga ky burim i të ardhurave. Arsyet kryesore mbi këtë situatë lidhen me:

- 12) Ligj nr. 9917, datë 19.5.2008 Për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
 13) Ligj nr. 92/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar
 14) Udhëzimi nr 22, datë 19.11.2014 Për Mbikqyrjen e OJF-ve nga Autoritetet Tatimore në Mbështetje të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
 15) Po aty, Neni 4
 16) Po aty, Neni 7
 17) Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", Neni 35

- Procedura burokratike dhe jo transparente në shpërndarjen e fondeve;
- Mungesa e kapaciteteve të OSHC-ve për të marrë pjesë në skemat e financimit;
- Nepotizëm dhe klientelizëm.

Një tjetër burim i rëndësishëm i të ardhurave për OSHC-të janë të ardhurat nga aktiviteti ekonomik. Kuadri ligjor ekzistues lejon OSHC-të të angazhohen në aktivitete ekonomike¹⁸, duke synuar gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve të tyre, në mënyrë që të kenë një burim të qëndrueshëm të të ardhurave, të pavarur nga shteti apo donacionet e tjera. Me ndryshimet e fundit në Ligjin e OJF-ve, është përshkruar qartësisht kuptimi i “aktivitetit ekonomik”¹⁹.

Pavarësisht qartësisht ndërmjet aktivitetit

ekonomik dhe aktivitetit jo - ekonomik, kuadri ligjor ekzistues nuk është ende favorizues ndaj ushtrimit të aktivitetit ekonomik nga OSHC-të. Si rezultat, vetëm 14% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan që sigurojnë të ardhura nga shitja e mallrave dhe/apo shërbimeve.

Fondet nga individët dhe korporatat janë një tjetër burim i të ardhurave për OSHC-të, edhe pse nuk konsiderohen dhe përdoren në nivele domethënëse nga këto të fundit. Pavarësisht rritjes që Shqipëria reflekton në Raportin e Indeksit Botëror të Dhurimit 2014, me 10 pikë nga vlerësimi i bërë para pesë vitesh²⁰, përqindja e OSHC-ve që e vlerësojnë të lehtë për të kërkuar dhe siguruar fonde nga dhurimet individuale dhe korporatat mbetet e njëjtë me vitin e kaluar (26% e OSHC-ve të intervistuar).

Vlerësimi i Standartit 1, Nën – fusha 1.1. reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020²¹: 1.1.a. Vlerësimi cilësor i kuadrit ligjor dhe politikave ekzistuese; 1.1.b. Progresi në lidhje me miratimin dhe zbatimin e kuadrit përkatës; 2.1.a. Perceptimi i OSHC-ve mbi lehtësirat dhe efektivitetin e rregullave financiare dhe kërkesave të raportimit (të ndarë sipas llojit/madhësisë së OSHC-ve) dhe 2.1.b. Vlerësimi cilësor i rregullave të financimit (me fokus ngritjen e mekanizmave që rregullat dhe detyrimet financiare të ndryshojnë në varësi të ndryshimit të qarkullimit dhe aktivitetit jo-fitimprurës).

Kuadri ligjor dhe politikat ekzistuese për ushtrimin e të drejtës së organizimit, në përgjithësi janë të favorshme, mundësuese dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ka një perceptim dhe eksperiencë më pozitive të OSHC-ve me zbatimin e tij gjatë 2014, krahasuar me një vit më parë. Detyrimi për të regjistruar një OSHC në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës paraqet kosto shtesë për individët dhe subjektet juridike që kanë për synim krijimin e një OSHC-je.

Në lidhje me rregullat financiare dhe kërkesat e raportimit, ato nuk janë vlerësuar si të qarta, efektive apo mbështetëse për funksionimin e OSHC-ve. Ato nuk janë të bazuara në karakteristikat e OSHC-ve, dhe nuk janë në proporcion me qarkullimin e OSHC-ve (nuk ka formate të ndryshme). Rregullat e kontabilitetit dhe formatet e raportimit të OSHC-ve janë të njëjta me rregullat e kontabilitetit dhe formatet e raportimit të bizneseve.

Nën-fusha 1.2.: Liritë e tjera

Vlerësimi i kësaj nën-fushe është bazuar në standartin e mëposhtëm: Standarti 1: Përfaqësuesit e OSHC-ve individualisht apo

përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore.

Kuadri ligjor në Shqipëri rreth lirisë së mbledhjes paqësore nuk ka qenë subjekt i ndryshimeve

18) Po aty, Neni 2

19) Ligj nr. 92/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 « mbi Organizatat Jo-fitimprurëse », i ndryshuar, Neni 1

20) Indeksi Botëror i Dhurimit 2014, Një Vështrim Global mbi Trendet e Dhurimit, Nëntor 2014, fq.27

21) http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/civil_society/doc_guidelines_cs_support.pdf

22) Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 46, 47

gjatë vitit të fundit. Ai garanton të drejtën e lirisë së organizimit si një e drejtë themelore e njeriut e sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë²² dhe në Ligjin “Mbi Tubimet”²³. Ata që synojnë grumbullimet paqësore nuk detyrohen nga ligji të kërkojnë leje për të bërë organizime të tilla. Drejtuesit janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tre ditë para datës së zhvillimit të tubimit²⁴.

Ndërsa kuadri ligjor nuk ka ndryshuar, perceptimi dhe eksperiencia e OSHC-ve në lidhje me ushtrimin e të drejtës së organizimit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në të gjithë indikatorët e matur, krahasuar kjo me Raportin e MM 2013. Kështu, ka një rritje prej 14% të OSHC-ve të intervistuar që deklarojnë se liria e tubimit është respektuar, një rritje prej

20% të OSHC-ve të intervistuar që deklarojnë se ka raste të mbledhjes së organizimeve spontane dhe simultane pa autorizim paraprak, një rritje prej 11% të OSHC-ve të intervistuar që deklarojnë se nuk ka përdorim të forcës së ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit gjatë organizimeve.

Këto të dhëna rforcojnë faktin se shteti njih si detyrim të tij lehtësimin dhe mbrojtjen e grumbullimeve paqësore. Kjo u evidentua edhe gjatë grumbullimit të organizuar nga shoqëria civile në nëntor 2013 ndaj planeve të qeverisë për të shkatërruar armët kimike siriane në Shqipëri. Dhe ajo që është më e rëndësishme, opinioni i shoqërisë civile u mor në konsideratë nga qeveria dhe kryeministri në vendimin final përse i përket çështjes në fjalë.

Vlerësimi i Standartit 2, Nën – fusha 1.1. reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020: 1.1.a. Vlerësimi cilësor i legjislacionit ekzistues dhe kuadrit të politikave; 1.1.b. Progresi në lidhje me miratimin dhe zbatimin e kuadrit përkatës.

Kuadri ligjor dhe politikat ekzistuese për ushtrimin e së drejtës së organizimit garanton të drejtën e lirisë së organizimit paqësor për të gjithë individët dhe subjektet juridike dhe nuk ka qenë objekt ndryshimesh gjatë vitit 2014. Legjislacioni kërkon njoftimin paraprak nga udhëheqësit e tubimeve për të ushtruar të drejtën e organizimit. OSHC-të e intervistuar raportojnë që vërehet një qëndrim më pozitiv i shtetit për të respektuar këtë të drejtë themelore të njeriut, krahasuar me vitin 2013.

Fusha 2: Kuadri për Qëndrueshmërinë dhe Lehtësirat Financiare për OSHC-të

Nën-Fusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre

Vlerësimi i kësaj nën-fushë është bazuar në standartin e mëposhtëm: Standart 1: Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve.

Siç është cituar në Indeks të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2013²⁵ “qëndrueshmëria financiare vazhdon të mbetet çështja më urgjente me të

cilën përballë shoqëria civile”. Burimi kryesor i financimit mbeten grantet nga donatorë të huaj, ndërsa burimet vendase (qeveria qendrore dhe vendore, dhurimet, shërbimet kundrejt pagesës, etj.) mbeten në nivele të ulëta, duke mos kontribuar në qëndrueshmërinë financiare të OSHC-ve. Sikundër është reflektuar në grafikun 6 më poshtë, 60% e organizatave të intervistuar raportuan të ardhura vjetore deri në 50.000 euro. Ka dy (2) organizata të intervistuar që kanë raportuar të ardhura vjetore domethënëse midis 500,000 – 1 milion euro: Fondacioni ABC dhe Fondacioni Dorcas. Ndërsa Fondacioni ABC është krijuar përmes fondeve të biznesit si

23) Ligji Nr. 8773, i datës 23.4.2001, “Mbi Tubimet”


24) Po aty, Neni 5

25) USAID, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2013 Për Evropën Qendrore e Lindore dhe Euroazine, Qershor 2014, fq 13

dhurim i kushtëzuar dhe ushtron veprimtari si agjenci donatore në vend, Fondacioni Dorcas Aid International është një organizatë bamirëse që ushtron veprimtarinë në 18 shtete, me zyrat qëndrore në Hollandë. E vetmja organizatë

që ka një buxhet mbi 1 milion euro është Fshati i Fëmijëve SOS, anëtare e organizatës ndërkombëtare SOS Kinderdorf International, e pranishme në 132 shtete në mbarë botën, e cila mbështet fëmijët, familjet dhe komunitetet.

Grafiku 6. Të ardhurat vjetore të OSHC-ve



Në lidhje me trajtimin tatimor të OSHC-ve dhe donatorëve të tyre, me ndryshimet e fundit të ligjit të OJF-ve²⁶, të gjitha të ardhurat nga burime tradicionale jo-fitimprurëse si dhurimet, grantet, depozitat bankare dhe tarifrat e anëtarësisë nuk janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Ndërsa OSHC-të që ushtrojnë aktivitete ekonomike i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat vetëm nëse të ardhurat e realizuara nuk destinohen për veprimtari, për të cilat organizata është regjistruar²⁷. Një tjetër ndryshim i rëndësishëm që kanë sjellë këto amendime është përshkrimi i “aktivitetit ekonomik” dhe “grante”²⁸, duke qartësuar kuptimin e të dyja koncepteve. Edhe pse këto amendime kanë kontribuar pozitivisht në përmirësimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e OSHC-ve në Shqipëri, ende gjatë vitit 2014 OSHC-të kanë ndeshur sfida gjatë veprimtarisë së tyre për shkak të regjimit tatimor në vend.

Duke marrë në konsideratë këtë situatë, trajtimi tatimor i OSHC-ve ishte një nga tre çështjet prioritare të adresuara në konferencën

kombëtare “Partnerë Social – Koha për Veprim” organizuar në dhjetor 2013 nga Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me zyrën e kryeministrit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Shqipëri dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Më specifikisht, ndërmjet shumë çështjesh, sektori i OSHC-ve kërkoi angazhimin e qeverisë për të adresuar çështjet e mëposhtme me qëllim përmirësimin e mjedisit rregullator për aktivitetin e organizatave të shoqërisë civile në vend:

- Qartësimi i përjashtimit të granteve nga skema e TVSH-së;
- Garantimi i rimbursimit të TVSH-së mbi fondet e BE-së në mbështetje të OSHC-ve si pjesë e detyrimit të qeverisë Shqiptare drejt Bashkimit Evropian;
- Rregullimi dhe trajtimi i diferencuar i aktivitetit ekonomik nga ana e OSHC-ve.

Pas konferencës, gjatë vitit 2014, Grupi i Punës për Mjedisin Mundësues për Shoqërinë Civile në Shqipëri advokoi për zbatimin e çështjeve të

26) Ligj nr. 92/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”, i ndryshuar

27) Po aty

28) Po aty, Neni 1

29) Ligj 92/2014, datë 24.07.2014 Mbi TVSH në Republikën e Shqipërisë

mësipërme dhe si rezultat, edhe pse nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat e OSHC-ve ka disa zhvillime të reflektuara në ligjin e ri të TVSH-së²⁹ që do të hyjë në fuqi në Janar 2015 dhe në vendimin i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014.

Disa nga ndryshimet kryesore në ligjin e TVSH-së që ndikojnë në sektor janë si vijon:

- a) Në nenin 3, ligji përshkruan se çdo burim jo-fitimprurës i OSHC-ve si: tarifë anëtarësie, fonde apo grante dhe dhurimet nuk janë subjekt i TVSH-së³⁰. Në këtë mënyrë është qartësuar përjashtimi i granteve nga skema e TVSH-së.
- b) Aktiviteti ekonomik i OSHC-ve është rregulluar me ligj. Aktivitetet ekonomike që kanë karakter social, edukues, kulturor dhe sportive, të quajtura “aktivitete me interes publik” janë të përjashtuara nga TVSH-ja³¹. Vendimi i Këshillit të Ministrave³² vendos kriteret për OSHC-të që të përjashtohen nga TVSH-ja dhe kriteret për vlerësimin e qëllimit jo-fitimprurës të aktivitetit ekonomik të OSHC-së. Vendimi i ri përcakton një tavan prej 20% të të ardhurave vjetore, si nivelin e lejuar për veprimtari ekonomike të kryer nga OJF-të dhe vendos një limit minimum prej 5 milion lekë gjatë një viti kalendarik për t’u regjistruar në skemën e TVSH-së.
- c) Statusi i përfitimit publik është shfuqizuar. Tani, mallrat dhe shërbimet e ofruara nga organizatat jo-fitimprurëse dhe të përjashtuara nga TVSH-ja janë të përcaktuara në ligj si dhe me procedurën e re, sipas pikës b).
- d) Ligji i OJF-ve kërkon rregullimin e aktivitetit për ngritjen e fondeve, por deri më tani ka qenë i parregulluar. Vendimi i qeverisë prezanton rregulla për aplikimin e TVSH-së për aktivitetet e ngritjes së fondeve të kryera nga OJF-të.
- e) Detyrimi i qeverisë Shqiptare për të rimbursuar TVSH-në, si pjesë e marrëveshjeve financiare

dhe granteve, është rforcuar në ligjin e ri të TVSH-së³³. Kjo është një inkurajim për OSHC-të për t’u rimbursuar nga autoritetet përkatëse për projektet e BE-së bazuar në marrëveshjen midis Qeverisë dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Udhëzimit nr 4, datë 22 janar 2013 mbi rimbursimin e TVSH për grantet IPA, e lëshuar nga Ministria e Financave, si dhe marrëveshjeve bilaterale me donatorë të huaj.

Në lidhje me investimet pasive, i vetmi ndryshim ka ardhur me amendimet e fundit të ligjit të OJF-ve gjatë 2013, sipas të cilit, të ardhurat e OSHC-ve të realizuara nga interesat bankarë, një nga format e investimit pasiv, janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat³⁴.

Nuk ka një ligj specifik mbi dhurimet e kushtëzuara, por në praktikë Partnerët Shqipëri ka identifikuar një rast të dhurimit të kushtëzuar në vend. Fondacioni “Albanian Besa Capital” (ABC)³⁵, është krijuar në vitin 2008 me mision mbështetjen e sipërmarrjes private, veçanërisht biznesit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri. Si pjesë e punës së fondacionit është mbështetja e shoqërisë civile përmes projekteve. Fondacioni u krijua nga Fondi Besa, një institucion kredie me mision kontributin në rritjen ekonomike të vendit, në zonat urbane dhe gjysëm urbane, duke promovuar dhe financuar ndërmarrje të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Kur u krijua fondacioni ABC, një pjesë e kapitalit të Fondit Besa iu dha si kapital fillestar fondacionit për ta bërë atë operativ. Dy burimet e të ardhurave të fondacionit janë: interesat e depozitave bankare (kapitali fillestar) dhe të ardhurat si aksioner i Fondit Besa. Të ardhurat nga dhurimi i kushtëzuar janë të mjaftueshme për të mbuluar një pjesë të madhe të veprimtarisë së fondacionit dhe nuk ka vështirësi, barriera apo procedura të vështira për ushtrimin e veprimtarisë së tij.

30) Po aty, neni 3

31) Po aty, Neni 51, shkronja “ë”, “f”, “l”, “j”, “k”.

32) Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014

33) Ligj 92/2014, datë 24.07.2014 Mbi TVSH në Republikën e Shqipërisë, Neni 77, Pika 2

34) Ligj nr. 92/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”, i ndryshuar

35) www.abcfoundation.info

Vlerësimi i Standartit 1, Nën – fusha 2.1. reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorit të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020: 2.3.a. Cilësia e sistemit të përfitimeve tatimore për veprimtarinë dhe aktivitetet ekonomike të organizatave të shoqërisë civile.

Gjatë 2014, ka patur disa zhvillime në kuadrin tatimor të OSHC-ve si rezultat i miratimit të ligjit të ri mbi TVSH-në. Të ardhurat nga aktiviteti ekonomik në përputhje me misionin e OSHC-ve nuk janë objekt i tatimit mbi të ardhurat. “Aktivitetet në interes të publikut”, siç specifikohen në ligjin e TVSH-së, janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 953, datë 29.12.2014 vendos kriteret për OSHC-të që të përjashtohen nga TVSH-ja dhe kriteret për vlerësimin e qëllimit jo-fitimprurës të aktivitetit ekonomik të OSHC-së. Vendimi i ri përcakton një tavan prej 20% të të ardhurave vjetore, si nivelin e lejuar për veprimtari ekonomike të kryer nga OJF-të dhe vendos një limit minimumi prej 5 milion lekë gjatë një viti kalendarik për t’u regjistruar në skemën e TVSH-së.


Nën-Fusha 2.2.: Mbështetja e shtetit

Vlerësimi i kësaj nën-fushe bazohet në standartet e mëposhtme: Standarti 1: Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkëfinancimin e BE dhe granteve të tjera; Standarti 2: Financimi publik jepet në një mënyrë të paracaktuar dhe transparente.

Nuk ka financime publike në dispozicion të OSHC-ve për zhvillim institucional të tyre, sikurse 64%

e OSHC-ve të intervistuar deklarojnë se fondet publike nuk u përgjigjen nevojave të tyre, siç tregohet edhe në grafikun 7 më poshtë. Janë vetëm 24 nga 100 OSHC-të e intervistuar, të cilat kanë marrë fonde publike gjatë periudhës 2013-2014. Shuma e fondeve publike që ka përfituar secila organizatë varion nga 1,400 Euro – 20,000 Euro, ndërsa ekziston një rast “përjashtimi” prej 100,000 Euro, të përfituara nga Zyra e Millieukontakt Shqipëri për zbatimin e një projekti të financuar nga Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim IADSA³⁶.

Grafiku 7. Fondet publike u përgjigjen nevojave të OSHC-ve.



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është enti kryesor publik, i cili siguron fonde publike për OSHC-të. Ky mekanizëm, i krijuar

përmes një ligji të veçantë³⁷ është i centralizuar dhe targeton specifikisht OSHC-të. Buxheti i alokuar për Agjencinë për vitin 2014 nga buxheti i

36) <http://www.iadsa.info/index.php?lang=3>

37) Ligj Nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”

shtetit, është rreth 715,000 Euro (100,000,000 Lek). Gjatë vitit 2014, Agjencia shpalli dy thirrje për projekt propozime. Thirrja e parë u publikua në maj 2014 dhe thirrja e dytë u shpall në gusht 2014. Deri në shtator 2014, Agjencia ka shpërndarë 51% të buxhetit vjetor për OSHC-të, duke disbursuar fonde për fituesit e thirrjes së tretë dhe të katërt, të shpallura gjatë vitit 2012, dhe fituesve të thirrjes së pestë dhe të gjashtë, të cilat u shpallën gjatë 2014³⁸, nga të cilat 64 OSHC janë shpallur fituese.

Fushat e prioriteteve për mbështetje financiare janë në të njëjtën linjë me prioritetet strategjike të qeverisë, në përputhje me ligjin për krijimin e Agjencisë, dhe nuk marrin në konsideratë nevojat dhe prioritetet e sektorit. Ndërsa financimi për mbështetje institucionale është një nga llojet e mbështetjes që Agjencia duhet të ofrojë për OSHC-të, në bazë të Rregullores mbi procedurat e financimit me grante, ky lloj financimi ende nuk është praktikuar nga ana e Agjencisë.

Duke synuar rritjen e mbështetjes për projekte dhe bashkë-financime për OSHC-të, AMSHC po punon për krijimin e një Fondi të Përbashkët me donatorë të tjerë për të mbështetur projekte të përbashkëta që kanë rëndësi strategjike për vendin. Në 17 nëntor 2014 Bordi Mbikqyrës i Agjencisë vendosi që 20% e fondit të grantit të AMSHC-së të jetë pjesë e fondit të përbashkët dhe të shkojë për financimin e projekteve strategjike³⁹.

Përmirësime në kuadrin ligjor dhe puna praktike e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, si një mekanizëm i rëndësishëm për mbështetjen e kontributit të organizatave të shoqërisë civile në forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, ishte një nga fushat prioritare të adresuara në konferencën kombëtare "Partnerë Socialë – Koha për Veprim". Anëtarët e rinj të Bordit Mbikqyrës dhe Drejtori Ekzekutiv i ri u përzgjedhën në fillim të vitit 2014. Në raportin e përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) mbi AMSHC-në "transparenca dhe gjithëpërfshirja e procesit

të përzgjedhjes së Bordit dhe Drejtuesit të AMSHC është adresuar pjesërisht"⁴⁰.

Drejtori i ri ekzekutiv dhe bordi i AMSHC-së gjatë vitit 2014 kanë ndjekur një përqasje më të hapur me OSHC-të duke organizuar një seri takimesh konsultative me OSHC-të për zhvillimin e një partneriteti strategjik, në kuadër të përgatitjes së Strategjisë Afat-mesme dhe Afat-gjatë të Agjencisë⁴¹, nëpërmjet përgatitjes dhe publikimit të gazetës online dhe pjesëmarrjes në nisma të rëndësishme të sektorit si krijimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, etj.

Megjithatë, OSHC-të ende nuk janë të kënaqura me funksionimin e AMSHC-së dhe kanë shprehur shqetësime lidhur me:

- Procedura të vështira, kosto financiare shtesë dhe kohë e pamjaftueshme në lidhje me procedurat e aplikimit;
- Mungesë e transparencës në procesin e përzgjedhjes dhe dhënies së përgjigjeve mbi arsyet e refuzimit të një aplikimi;
- Një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve të regjistruara në 2014 janë shpallur fituese duke nënvlerësuar organizata të njohura që kanë lënë gjurmë në sektor;
- Para – përzgjedhja e fituesve;
- Në thirrjen e fundit nuk është dhënë asnjë informacion mbi limitin e buxhetit minimal dhe maksimal për projektet e dorëzuara.

Gjatë vitit 2014, përveç fondeve të AMSHC-së, Ministria e Kulturës ka dhënë fonde publike duke synuar promovimin e artit e kulturës në Shqipëri. Deri në nëntor 2014, Ministria ka shpallur 2 thirrje për projekt propozime, thirrja e parë në janar 2014 dhe thirrja e dytë në maj 2014. Thirrjet nuk kanë adresuar specifikisht OSHC-të, por një numër prej 53 OSHC, të cilat punojnë në fushën e artit dhe kulturës kanë përfituar nga këto fonde. Fondi financiar i thirrjes së majit ishte 18,000,000⁴² Lekë dhe një OSHC mund të kërkonte mbështetje financiare nga 100,000 Lekë në 1,500,000 Lekë⁴³, ndërsa në thirrjen e janarit një OSHC

38) http://www.amshc.gov.al/web/raporte/monitorimi/2014/Raporti_per_3-mujorin_3_te_vitit_2014.pdf

39) <http://www.amshc.gov.al/web/newsletter/2014/3.pdf>

40) Për një AMSHC më Pranë Shoqërisë, Gjergji Vurmo & Orsiola Kurti, IDM, fq.2

41) www.amshc.gov.al/web/veprimtari/2014/2014.10.7-9-Takime-Konsultative-english.php

42) <http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/njoftime/thirrja-per-projekt-propozime-12-30-maj-2014-projektet-e-perzgjedhura-per-mbeshtetje>

43) <http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/njoftime/thirrje-per-projekt-propozime-ne-fushat-e-artit-dhe-kultures&page=6>

mund të aplikonte për fonde nga 100,000 Lek në 2,000.000 Lekë⁴⁴.

Një burim tjetër i financimit publik për OSHC-të të cilat ofrojnë shërbime sociale, është Lotaria Kombëtare e krijuar përmes një ligji të veçantë në 2013⁴⁵. Është e specifikuar në ligj se një kontribut i detyrueshëm prej 2,2% të xhiros vjetore të të licencuarit i dedikohet “çështjeve në të mirë të publikut”. Përzgjedhja e projekteve, organizatave apo aktiviteteve që do të përfitojnë nga ky fond do të bëhet nga Bordi për Çështje të Mira, i cili do të krijohet përmes një Vendimit të Këshillit të Ministrave, që pritet të dalë së shpejti. Ai do të përbëhet nga katër përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe tre përfaqësues të kompanisë së licencuar. Bordi do të marrë vendimet sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe një

Udhëzim të Ministrit të Financave, i cili ende nuk është publikuar. Përbërja e Bordit vetëm me përfaqësues nga Ministria e Financave dhe kompania e licencuar e vë në pikëpyetje cilësinë e projekteve që do të financohen përmes Lotarisë Kombëtare.

Krahasuar me Raportin e MM 2013, nuk ka ndryshime të rëndësishme në perceptimin e OSHC-ve sa i përket financimit publik në mënyrë të paracaktuar dhe transparente, duke i konsideruar si të arritura pjesërisht. Kështu, 51% e OSHC-ve të intervistuar deklarojnë se financimi nuk është i paracaktuar, përkundrajt 58% të OSHC-ve të intervistuar gjatë 2013, ndërsa 58% e OSHC-ve të intervistuar deklarojnë se pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin e financimit publik është jo transparente, përkundrajt 57% e OSHC-ve të intervistuar gjatë 2013.

Vlerësimi i standartit 1, Nën – fusha 2.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020: 2.4.a. Raporti i shumës së kërkuar përkundrajt shumën së aprovuar / disbursuar çdo vit përmes fondeve publike për OSHC-të (kjo dëshmon disponueshmërinë e fondeve) dhe 2.4.b Cilësia e kornizave të financimit shtetëror për organizatat e shoqërisë civile (fokusuar mbi dokumentat proceduriale).

Mekanizmi i vetëm shtetëror me mision sigurimin e fondeve publike për OSHC-të është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Deri në shtator 2014, Agjencia ka disbursuar 51% të shumës së përgjithshme vjetore të fondeve publike të miratuara për OSHC-të. Procedurat e financimit janë përshkruar në mënyrë të qartë dhe janë vënë në dispozicion të publikut në respektim të kuadrit ligjor dhe rregulloreve të brendshme të Agjencisë. Zbatimi i këtij kuadri ligjor mbetet problematik, pasi OSHC-të vlerësojnë se procedurat e aplikimit janë të rënduara dhe procesi është jo transparent.

Nën-fusha 2.3.: Burimet njerëzore

Vlerësimi i kësaj nën- fushë bazohet në standartet e mëposhtme: Standarti 1: OSHC-të trajtohen në një mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë; Standarti 2: Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizmin.

Kudri ligjor shqiptar lidhur me burimet njerëzore është i njëjtë për të gjithë punonjësit dhe i aplikuar pa trajtime diferenciale për OSHC-të. Ato trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe janë subjekt i kërkesave

dhe detyrimeve të njëjta nga ligji, pa diskriminim apo nisma nxitëse. E njëjta situatë reflektohet edhe nga gjetjet e intervistave me OSHC-të, pasi 45% e tyre deklarojnë se politikat e shtetit mbi punësimin nuk janë nxitëse. Kuadri ligjor mbi sigurimet shoqërore⁴⁶ mbetet problematik për OSHC-të në lidhje me detyrimin për të paguar sigurime për të paktën një punonjës, edhe kur organizata nuk ka asnjë projekt, aktivitet apo financim. OSHC-të kanë raportuar që kanë patur penalitete nga autoritetet tatimore për këtë arsye.

44) <http://www.kultura.gov.al/newsroom/njoftime/aplikimi-per-financimin-dhe-mbeshtetjen-e-projekteve>


45) Ligj 95/2013 Për Miratimin e Marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si Autoritet i Autorizuar dhe Shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet Shoqërisë “Olg Project” Shpk

46) Ligj, nr 7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”


Bazuar në gjetjet e studimit të kryer nga PSH, siç reflektohet në grafikun 8 dhe 9 më poshtë, shumë nga organizatat që kanë marrë pjesë në studim kanë 0-5 punonjës me kohë të plotë ose/dhe me kohë të pjesshme (73% e OSHC-ve të intervistuar kanë 0-5 punonjës me kohë të plotë dhe 70% e OSHC-ve të intervistuar kanë 0-5 punonjës me kohë të pjesshme). Ka pak organizata që kanë më tepër se 25 punonjës me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme, si

Youth Albanian Parcel Services (YAPS) me 89 punonjës me kohë të plotë dhe Fshati i Fëmijëve SOS me 97 punonjës me kohë të plotë, Shoqata Ndërkombëtare për Solidaritet me 50 punonjës me kohë të pjesshme dhe Qendra e Këshillimit për Persona me Aftësi të Kufizuar me 55 punonjës me kohë të pjesshme. Të gjitha këto organizata punojnë në fushën e shërbimeve sociale, ofrojnë shërbime me pagesë ndaj grupeve të interesit dhe ushtrojnë veprimtari si ndërmarrje sociale.

Grafiku 8. Numri i punonjësve me kohë të plotë



Grafiku 9. Numri i punonjësve me kohë të pjesshme



Sikundër citohet edhe në Indeksin e Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2013 “vullnetarizmi është i pazhvilluar dhe vendimmarrësit nuk kanë vepruar ende mbi draft ligjin mbi Vullnetarizmin, të përgatitur nga një koalicion i organizatave ri-

nore, tre vite më parë”⁴⁷. Si rezultat, nuk ka programe shtetërore të zhvilluara mbi vullnetarizmin. Kur u pyetën nëse kanë informacion për programeve shtetërore mbi vullnetarizmin, 76% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se nuk kanë

47) USAID, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2013 Për Evropën Qendrore e Lindore dhe Euroazine, Qershor 2014, fq 13


informacion, ndërsa 22% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se kanë informacion, por ato iu referoheshin praktikave të studentëve në institucionet dhe organizatat, si pjesë e kurrikulës së tyre akademike.

Ndërsa shteti nuk ndalon vullnetarizmin spontan, ai vendos detyrime ligjore për të deklaruar dhe regjistruar vullnetarët në zyrën e punësimit, dhe për të paguar sigurime mbi ta, përndryshe ka dënime të ashpra. Prandaj, OSHC-të konsiderojnë të rëndësishme miratimin e një ligji mbi vullnetarizmi që do të rregullonte marrëdhëniet ndërmjet OSHC-ve dhe vullnetarëve, si dhe midis OSHC-ve dhe shtetit.

Mungesa e stimuljeve ekzistues për të mbështetur vullnetarizmin është reflektuar edhe në rezultatet e studimit, sikundër vërehet në

grafikun 10 më poshtë. Shumica e organizatave (51%) kanë 0-10 vullnetarë. Ka 11 organizata që kanë më shumë se 100 vullnetarë si: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Këshilli Rinor Shqiptar, Balkan Youth Link Albania, Roma Active Albania, YMCA Shqipëri, Forumi i OSHC-ve në Pogradec, Agjencia Artistike e Spektakleve në Korçë, Klubi Ekologjik i Elbasanit, dhe Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD). Ka dy organizata me 1000 e më shumë vullnetarë që janë Unioni i Gazetareve dhe Shoqata për Kulturë Demokratike. Këto janë organizata me anëtarësi dhe zhvillojnë fushata massive, si mobilizimi i vëzhguesve vendorë nga koalicioni i vëzhguesve vendorë, pjesë e të cilit është Shoqata për Kulturë Demokratike. Vullnetarët janë të angazhuar kryesisht mbi baza të përkohshme, sipas nevojave të organizatës për kryerjen e aktiviteteve specifike.

Grafiku 10. Numri i vullnetarëve



Vlerësimi i Standartit 1 dhe Standartit 2, Nën – fusha 2.3., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020: 1.2.a. Numri i punonjësve në OSHC (me kohë të plotë dhe të pjesshme); 1.2.b. Numri i vullnetarëve në OSHC për llojin e OSHC/sectorit dhe 1.2.c. Cilësia e kuadrit ligjor.

Nuk ka të dhëna zyrtare statistikore mbi numrin e të punësuarve (me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme) dhe numrin e vullnetarëve në OSHC. Kuadri ligjor i punës nuk është diskriminues, as stimuluese për OSHC-të. Nuk ka një kuadër ligjor për rregullimin e vullnetarizmit të OSHC-ve, pavarësisht përpjekjeve dhe iniciativave për të përgatitur dhe dorëzuar një draft ligj mbi vullnetarizmit nga OSHC-të tek autoritetet publike përkatëse që në vitin 2011.

Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC

Nën-fusha 3.1.: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

Vlerësimi i kësaj nën – fushe bazohet në standartet e mëposhtme: Standarti 1: Shteti njeh, përmes strategjive dhe politikave, rëndësinë e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin; Standarti 2: Shteti njeh, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të.

Bashkëpunimi midis Qeverisë dhe OSHC-ve është i rëndësishëm për të krijuar një kuadër ligjor efektiv, politika dhe strategji për zhvillimin e sektorit të organizatave të shoqërisë civile. Gjetjet nga vëzhgimi me OSHC-të gjatë vitit 2014 treguan se bashkëpunimi midis Qeverisë dhe OSHC-ve është përmirësuar. Krahasuar me gjetjet e Raportit të Matricës së Monitorimit 2013, ku vetëm 14% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se bashkëpunimi midis Qeverisë dhe OSHC-ve ishte përmirësuar, në vitin 2014, 43% e OSHC-ve të intervistuar kanë deklaruar se bashkëpunimi midis Qeverisë dhe OSHC-ve ishte përmirësuar.

Një nga dokumentet kryesore që do të shërbejë si një dokument strategjik për bashkëpunimin dhe rritjes së dialogut mes Qeverisë dhe shoqërisë civile është Udhërrëfytesa (Road Map) i politikave të Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e Shoqërisë Civile që është përgatitur gjatë vitit 2014. Udhërrëfytesa (Road Map) synon të orientojë qeverinë drejt marrjes së vendimeve efikase për përmirësimin e mjedisit të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Dokumenti është në përputhje me Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit 2014 - 2020, i cili synon të sigurojë një kornizë solide për matjen e progresit në zhvillimin dhe mundësimin e një demokracie stimuluese dhe me pjesëmarrje në vendet që synojnë anëtarësimin në BE⁴⁸. Dokumenti është përgatitur në konsultim me OSHC-të, përmes një seri takimesh konsultative të organizuara nga Zyra e TACSO-s në Shqipëri.

Gjatë këtij viti, në vijim të angazhimit të ndërmarrë nga qeveria Shqiptare gjatë konferencës

kombëtare “Partnerë Socialë - Koha për Veprim” organizuar në dhjetor 2013, ka nisur procesi për zhvillimin e dokumentave strategjike dhe krijimin e mekanizmave të partneritetit ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve. Progres i rëndësishëm është materializimi i dy çështjeve strategjike të trajtuara në konferencën e dhjetorit që do të kontribuojnë për institucionalizimin e partneritetit ndërmjet shtetit dhe OSHC-ve, të cilat janë:

1. Miratimi i Kartës për Shoqërinë Civile në Kuvendin e Shqipërisë;
2. Krijimi i Këshillit Kombëtar të Bashkëpunimit midis Qeverisë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile⁴⁹.

Më 24 dhjetor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi “Rezolutën për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimeve Demokratike të Vendit”, dokumenti i parë politik që njeh dhe përcakton angazhimet konkrete në këtë drejtim. Përgatitja e rezolutës u bazua në Kartën e Shoqërisë Civile e hartuar dhe prezantuar fillimisht në vitin 2009 dhe e prezantuar sërish në kuvend nga Grupi i Punës për Mjedisin Mundësues për Shoqërisë Civile në Shqipëri. Më 22 Tetor 2014, Nën-komisioni për të drejtat e njeriut organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e OSHC-ve, organizatave ndërkombëtare, deputetë dhe anëtarë të Këshillit të Ministrave, për të diskutuar mbi Kartën e Shoqërisë Civile.

Përmes dialogut, bashkëpunimit dhe punës të vazhdueshme të Grupit të Punës për Mjedisin Mundësues për Shoqërisë Civile me qeverinë, pas takimit me Kryeministrin më 9 maj 2014, u përgatit projekt ligji për “Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”, një organ këshillimor i pavarur pranë Këshillit të Ministrave. Krijimi i Këshillit do të garantojë bashkëpunimin institucional ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile në Shqipëri, në mbështetje të përmirësimit të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë, rritjes së transparencës në hartimin e politikave dhe vendimmarrjes, si rezultat i përfshirjes së shoqërisë civile në këto procese. Projekt ligji për krijimin e këshillit do të diskutohet përmes një procesi të gjerë konsultimesh me shoqërinë civile dhe ministrinë e linjës, përpara se të dërgohet në

48) <http://www.tacso.org/news/events/?id=11014>

49) http://www.partnersalbania.org/Statement_of_civil_society.pdf

kuvend për diskutim dhe miratim në fillim të vitit 2015.

Që prej vitit 2013, janë krijuar disa mekanizma / struktura në nivel të qeverisjes qendrore, për t'u marrë me çështjet e shoqërisë civile dhe për të lehtësuar ndërveprimin e institucioneve me shoqërinë civile. Për t'u përmendur janë:

Zyra për Koordinimin me Grupet e Interesit në Kuvendin e Shqipërisë, Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj në Kryeministri, Sektori i Shoqërisë Civile dhe Strategjisë në Ministrinë e Integritimit Evropian; Bordi Këshillimor i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut pranë Avokatit të Popullit.

Vlerësimi i Standartit 1 dhe Standartit 2, Nën – fusha 3.1., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020: 3.1.b. Cilësia e strukturave dhe mekanizmave në vend për dialog dhe bashkëpunim midis OSHC-ve dhe institucioneve publike në drejtim të: - përfaqësimit të OSHC-ve në përgjithësi, - përfaqësimit të OSHC-ve të vogla – vizibiliteti dhe disponueshmëria e tyre, - perceptimi i Qeverisë mbi cilësinë e strukturave dhe mekanizmave, - perceptimi i OSHC-ve mbi strukturat dhe mekanizmat.

Strukturat dhe mekanizmat për dialog dhe bashkëpunim midis institucioneve publike dhe OSHC-ve janë në proces të ngritjes së tyre si Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe miratimi i “Rezolutës për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimeve Demokratike të Vendit”. Krijimi i strukturave dhe mekanizmave të tillë përfaqëson një progres në marrëdhëniet midis sektorëve dhe sikundër është vlerësuar edhe nga OSHC-të e intervistuar, kjo ka kontribuar në përmirësimin dhe rritjen e bashkëpunimit midis Qeverisë dhe OSHC-ve.

Nën – fusha 3.2.: Përfshirja në proceset e hartimit të politikave dhe vendim-marrjes

Vlerësimi i kësaj nën – fushe bazohet në standartet e mëposhtme: Standarti 1: Ekzistojnë standarte që mundësojnë përfshirjen e OSHC-ve në vendim-marrje, të cilat lejojnë kontributin e OSHC-ve në kohën e duhur; Standarti 2: Të gjitha projekt ligjet dhe politikat janë lehtësisht të qasshme për publikun në kohën e duhur; Standarti 3: Përfaqësuesit e OSHC-ve janë partnerë të barabartë në diskutime në organet ndër-sektoriale dhe janë zgjedhur nëpërmjet kritereve dhe proceseve të përcaktuara qartë.

Në tetor 2014, u miratua ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik⁵⁰ duke përcaktuar detyrimet për konsultime mbi projekt ligjet, politikat dhe strategjitë me grupet e interesit. Ligji institucionalizon konsultimet publike në hartimin dhe miratimin e projekt ligjeve, strategjive kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik, me qëllimin

final për të përmirësuar cilësinë e politikave dhe akteve ligjore. Në përgjithësi, ligji është në linjë me standartet ndërkombëtare mbi njoftimet dhe konsultimet publike. Ligji parashikon krijimin e një regjistri online për njoftimet dhe konsultimet publike, i cili garanton aksesin e të gjithë grupeve të interesit duke siguruar në këtë mënyrë barazi në marrjen e informacionit dhe shërbimeve për të gjithë. Bazuar në ligj, OSHC-ve u jepet kohë e mjaftueshme për të përgatitur opinionet e tyre dhe për të ofruar rekomandime mbi projekt ligjet dhe politikat në përputhje me standartet ndërkombëtare⁵¹. Gjithashtu, ligji përcakton se një përmbledhje të opinioneve të mbledhura vihet në dispozicion të publikut dhe është pjesë e materialeve të dorëzimit të projekt ligjit për miratim. Nga ana tjetër, në qoftë se rekomandimi nuk pranohet, një përmbledhje me arsyet e mospranimit vihet në dispozicion të publikut. Ligji parashikon gjithashtu mënyra për rishikim nëse dispozitat për konsultime nuk respektohen, bazuar në kërkesat nga ana e grupeve të interesit.

50) Ligji nr 146/2014, datë 30.10.2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

51) Po aty, Neni 15

Ligji adreson shqetësimet kryesore të ngritura nga OSHC-të në lidhje me mungesën e dispozitave detyruese për autoritetet publike që të publikojnë projekt ligjet dhe politikat; mungesën e informacionit on-line dhe publikimin e projekt ligjeve dhe politikave; mungesën e afateve të qarta dhe të arsyeshme për dorëzimin e komenteve në lidhje me projekt ligjet; mungesën e përgjigjeve nga institucionet publike në formë të shkruar mbi rekomandimet e dhëna; mungesën e ftesave për konsultime publike; mungesën e transparencës mbi proceset e konsultimit dhe mungesën e informacionit mbi arsyet pse rekomandimet nuk janë marrë në konsideratë.

Një anë e dobët e ligjit është se lë jashtë fushës së zbatimit të tij aktet nënligjore normative, të cilat përbëjnë shumicën e kuadrit legjislativ, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e qytetarëve dhe grupeve të interesit⁵².

Ligji është rezultat i përpjekjeve afatgjata të shoqërisë civile, të cilat kanë nisur në vitin 2011 nga Fondacioni OSFA në Shqipëri në përmbushje të angazhimeve që Shqipëria ka ndërmarrë në kuadër të anëtarësimit të saj në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (*Open Government Partnership*), ashtu siç është edhe miratimi i një ligji të ri Mbi të Drejtën e Informimit⁵³ që garanton të drejtën e informimit të qytetarëve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në këtë aspekt është miratimi i Ligjit Nr. 93/2014 Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili në nenin 5 të tij "OSHC-të kanë të drejtë të konsultohen" përcakton detyrimet e autoriteteve publike që të konsultohen me individë me aftësi të kufizuara dhe OSHC që punojnë me dhe për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Zhvillimi i kuadrit ligjor mbi pjesëmarrjen në hartimin e politikave dhe vendim-marrje gjatë vitit 2014 është shoqëruar me një përqasje më të hapur, bashkëpunuese dhe transparente nga ana e institucioneve publike në nivel qendror, duke siguruar rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në këto procese. Gjetjet e vëzhgimit me OSHC-të tregojnë se ka një rritje prej 18% të OSHC-

ve të intervistuar, të cilat deklarojnë se niveli i pjesëmarrjes në vendim-marrje është rritur dhe një rënie prej 17% të OSHC-ve të intervistuar që deklarojnë se qasja publike në projekt ligje dhe politika është e vështirë dhe shumë e vështirë, krahasuar me gjetjet e Raportit të Matricës së Monitorimit 2013. Ka një seri nismash ligjore dhe rregullatore të përmendura nga OSHC-të që janë zhvilluar në konsultim me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, të tilla si: Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi përgatitur nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë; Plani Kombëtar i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP); Reforma Administrative – Territoriale përgatitur nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore; ndryshime në Kodin Penal nga Ministria e Punëve të Brendshme; Udhërrëfyes (Road Map) mbi 5 Prioritetet Kryesore nga Ministria e Integritimit Evropian, Paketa Fiskale për vitin 2015, etj.

Gjatë vitit 2014, Kuvendi i Shqipërisë ka qenë shumë aktiv në proceset konsultuese me publikun, grupet e interesit dhe shoqërinë civile për diskutimin e projekt ligjeve. Angazhimi më i rëndësishëm i kuvendit drejt përmirësimit të bashkëpunimit dhe marrëdhënies me shoqërinë civile ka qenë miratimi i "Rezolutës për Njohjen dhe Forcimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimeve Demokratike të Vendit". Komisionet parlamentare kanë qenë aktive në organizimin e seancave dëgjimore me grupet e interesit mbi projekt ligjet. Në faqen e internetit të kuvendit ka informacion mbi programin dhe axhendën e punës së komisioneve. Një zhvillim i rëndësishëm në punën e kuvendit ndaj rritjes së pjesëmarrjes dhe konsultimit me publikun është përgatitja e Projekt Manualit mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje. OSHC-të kanë qenë të ftuara on-line dhe në takimet konsultative për të dhënë rekomandimet e tyre mbi dokumentin.

Një shembull tjetër pozitiv i transparencës dhe konsultimit publik vjen nga Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike, që publikon në faqen e saj të internetit projekt ligjet dhe fton të gjitha palët e interesuara të japin opinionet e tyre mbi to.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive ka ende nevojë për përmirësime për të adresuar

52) <http://www.osfa.al/njofitime/rritja-e-perfshirjes-qytetare-ne-vendim-marrje-dhe-politikeberje>


53) Ligj nr. 119/2014 Mbi të Drejtën e Informimit

shqetësimet e OSHC-ve me qëllim për të përmirësuar dhe për të rritur përfshirjen në politikë –bërje dhe vendim - marrje, të tilla si: kohë e pamjaftueshme për proceset konsultuese dhe mungesa e reagimit ndaj komenteve dhe rekomandimeve të bëra nga shoqëria civile; mungesë ose nivel i ulët i reflektimit të komenteve të shoqërisë civile në dokumentet përfundimtare; preferenca mes OSHC-ve që janë ftuar në proceset e konsultimit; mungesa e informacionit të përditësuar në faqen e internetit të institucioneve publike, etj.


Të qënurit të përfaqësuar dhe partnerë të barabartë në diskutime në organet ndër-sektoriale të ngritura nga institucionet publike, bazuar në udhëzime të qarta dhe kritere transparente dhe të paracaktuara të përzgjedhjes, do të ishte niveli

më i lartë i pjesëmarrjes së OSHC-ve në proceset vendim - marrëse. Gjatë vitit 2014, nga pikëpamja e kuadrit ligjor situata nuk ka ndryshuar. Megjithatë nuk ka një ligj specifik që rregullon këtë çështje, në ligje të ndryshme është sanksionuar krijimi i organeve këshilluese. Ndërsa nuk ka ndryshime në legjislacion, në nivel praktik është vërejtur një situatë e përmirësuar sa i përket lehtësisë të procesit të përfaqësimit të OSHC-ve në organet ndërsektoriale siç është treguar në grafikët 11 dhe 12 më poshtë (11% e OSHC-ve të intervistuar më pak se në vitin 2013 e kanë të vështirë dhe shumë të vështirë përfaqësimin në organet ndërsektoriale) dhe në përzgjedhjen e qartë dhe transparente të OSHC-ve në këto struktura ndërsektoriale (25% e OSHC-ve të intervistuar më pak se në vitin 2013 deklarojnë se procesi i përzgjedhjes nuk është aspak dhe pak transparent).

Grafiku 11. Pjesëmarrja në strukturat e planifikimit ndërsektorial



Grafiku 12. Transparenca e procesit të përzgjedhjes së përfaqësuesve të OSHC-ve në këto struktura.



Ndërsa pjesëmarrja në organet ndër-sektoriale është e rëndësishme, koha dhe mundësia për të folur, shprehur opinionin dhe debatuar mbi çështjen është edhe më e rëndësishme. Praktika tregon se ky element i pjesëmarrjes është i respektuar në një nivel të konsiderueshëm, sepse 67% e OSHC-ve të intervistuar deklarojnë se OSHC-të shprehin dhe mbrojnë mendimin e tyre në këto organe. Në mënyrë që partneriteti të jetë një detyrim për të gjitha institucionet publike, OSHC-të sugjerojnë miratimin e një ligji të veçantë, i

cili i detyron institucionet publike të ftojnë përfaqësues të OSHC-ve në vendim-marrje dhe / apo organet këshilluese. Ndër kriteret e tjera të përmendura nga OSHC-të, janë: besimi dhe respekti i ndërsjellë, rritja e transparencës dhe korrektësisë në procesin e përzgjedhjes; përzgjedhja e përfaqësuesve të OSHC-ve nga vet OSHC-të; rritja e kapaciteteve të OSHC-ve për të qenë partnere të barabarta në këto organe; rregulla të qarta të pjesëmarrjes; rritja e bashkëpunimit; role dhe përgjegjësi të qarta bazuar në marrëveshje të shkruara, etj.

Vlerësimi i Standartit 2 dhe Standartit 3, Nën – fusha 3.2., reflekton gjithashtu vlerësimin e indikatorëve të mëposhtëm të Udhëzuesit të BE për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014 - 2020: 3.1.a. Përqindja e ligjeve/akteve ligjore, strategjive dhe reformave politike të konsultura efektivisht me OSHC-të dhe 3.1.b Cilësia e strukturave dhe mekanizmave në vend për dialog dhe bashkëpunim midis OSHC-ve dhe institucioneve publike.

Miratimi i ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik nga Kuvendi i Shqipërisë në tetor 2014, është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së përfaqësimit të OSHC-ve në proceset vendim-marrëse. Përkrah punës për përgatitjen dhe miratimin e ligjit, vërehet një rritje e pjesëmarrjes së OSHC-ve në konsultimet e ligjeve/akteve ligjore, strategjive dhe reformave politike gjatë vitit 2014, krahasuar me vitin 2013. Ende, vetëm 26% e OSHC-ve të intervistuar kanë raportuar se niveli i përfshirjes së OSHC-ve në vendim-marrje është i lartë, duke çuar në nevojën për një përfshirje më të madhe të OSHC-ve në vendim-marrje nga ana e institucioneve publike.

Nën-fusha 3.3.: Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve

Vlerësimi i kësaj nën – fushe bazohet në standartet e mëposhtme: Standarti 1: OSHC-të janë të angazhuara në shërbime të ndryshme dhe konkurrojnë për kontrata shtetërore mbi baza të barabarta me ofruesit e tjerë; Standarti 2: Shteti është angazhuar për financimin e shërbimeve dhe financimi është i parashikueshëm dhe i ofruar për një periudhë afat-gjatë; Standarti 3: Shteti ka përcaktuar procedura të qarta për kontraktimin e shërbimeve të cilat lejojnë për zgjedhjen transparente të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë edhe OSHC-të; Standarti 4: Ekziston një sistem i qartë i llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të ofrimit të shërbimeve.

Ndërsa ligji i OJF-ve lejon OSHC-të të ushtrojnë veprimtari në të mirë dhe përfitim të publikut,


dhe Ligji për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore lejon OSHC-të të ofrojnë shërbime sociale të financuara privatisht si dhe shërbime publike me financim nga buxheti i shteti, kuadri ligjor, i cili rregullon procedurat e prokurimit publik krijon shumë pengesa që e bëjnë pothuajse të pamundur për OSHC-të të konkurojnë për kontrata shtetërore me të njëjtat kërkesa si ofruesit e tjerë të shërbimeve⁵⁴. Kështu, të ardhurat nga prokurimet publike nuk janë një mundësi për OSHC-të. Krahasuar me burimet e tjera të financimit, prokurimi publik është një nga burimet ku OSHC-të sigurojnë më pak fonde. Ky tregues është i vetmi që është vlerësuar më negativisht nga OSHC-të, krahasuar me Raportin e MM 2013. Nga 75% të OSHC-ve të intervistuar që kanë deklaruar se nuk mund të kërkojnë dhe sigurojnë fonde nga prokurimi publik në vitin 2013, janë 91% e OSHC-ve të intervistuar që kanë zgjedhur këtë alternativë në vitin 2014, siç

54) Referohu Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2013, për më shumë specifikime mbi kuadrin ligjor ekzistues dhe pengesave.

pasqyrohet në grafikun nr. 13 më poshtë. Edhe pse OSHC-të janë ofruesit kryesorë privatë të shërbimeve në fushën e asistencës sociale, të

shëndetësisë dhe arsimit, shembujt e OSHC-ve që janë shpallur fitues të këtyre kontratave janë pothuaj inekzistente.

Grafiku 13. Të ardhurat nga prokurimi publik



Duke marrë në konsideratë ndikimin negativ që kjo situatë paraqet për zhvillimin e OSHC-ve, Partnerët Shqipëri organizuan gjatë vitit 2014 një strategji advokuese për të adresuar këtë çështje. Zbatimi i strategjisë nisi me hartimin e Dokumentit të Politikave mbi Prokurimin Social⁵⁵, duke adresuar kontraktimin e shërbimeve shoqërore, si një nga fushat kryesore në të cilat OSHC-të operojnë dhe janë ofruesit kryesorë private me përvojën dhe ekspertizën e nevojshme. Dokumenti paraqet kornizën ekzistuese ligjore në sigurimin social, pengesat për zhvillimin e procesit të kontraktimit social dhe pengesat në përgjithësi për ofrimin e shërbimeve sociale si: mungesa e traditës në ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare, mungesa e fondeve publike për shërbime sociale, mungesa e procedurave të përshtatshme për kontraktimin social, mungesa e kapaciteteve për të kontraktuar shërbime sociale, vonesa dhe probleme të tjera që lidhen me pagesat, OSHC-të shihen si një burim dhe jo

përfitues të fondeve, si dhe rekomandime për të siguruar që kontraktimi social është jo vetëm i mundshëm, por është edhe një praktikë kryesore në lidhje me ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale në Shqipëri. Përgatitja dhe miratimi i një ligji të veçantë mbi prokurimin social, i veçantë nga ai i prokurimit publik do të jetë e nevojshme për të adresuar çështjen e prokurimit dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga OSHC-të.

Si përfundim, dokumenti vlerëson që situata aktuale politike krijon një mundësi të rrallë për zhvillimin e prokurimit social. Në vazhdimësi të reformave që po zbatohen si Reforma e Shërbimeve Sociale nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Reforma Administrative-Territoriale nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, fakti që nuk ekziston pothuajse shërbimi social mbi baza komunitare, ofron një mundësi që kur këto shërbime të zhvillohen, OSHC-të të jenë partnere të shtetit në ofrimin e shërbimeve sociale.

55) <http://www.partnersalbania.org/?fq=brenda&m=news&gj=gj2&lid=131>

V. Gjetjet dhe Rekomandimet (Tabela) ⁵⁶

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën –fusha 1.1: Liria e organizimit

Parimi: Liria e organizimit është e garantuar dhe ushtrohet lirisht nga të gjithë

STANDARTET HAPËTË MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike mund të themelojnë, t'i bashkohen apo të marrin pjesë lirisht në organizata jo-formale apo të regjistruara, offline dhe online	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një kuadër ligjor sipas të cilit çdo person mund të krijojë shoqata, fondacione dhe lloje të tjera subjektsh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare (p.sh. kompani jo-fitimprurëse) për çfarëdo qëllimi. 2) Kuadri ligjor lejon si personat juridikë dhe individët të ushtrojnë këtë të drejtë pa diskriminim (moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie, etj). 3) Regjistrimi nuk është i detyrueshëm, dhe në rastet kur organizatat vendosin të regjistrohen, rregullat e regjistrimit janë të përcaktuara në mënyrë të qartë që të lejojnë një proces regjistrimi dhe apelimi të lehtë, jo shumë të gjatë në kohë dhe të pakushtueshëm. 4) Ligji lejon për krijimin e rrjeteve midis organizatave në vendet e tyre dhe jashtë, pa njoftim paraprak. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdokush mund të ushtrojë të drejtën e tij për të themeluar organizata, fondacione dhe qendra (tre llojet e OSHC-ve që njihen nga Ligji i Organizatave Jo Fitimprurëse; 2) Liria e organizimit është një e drejtë kushtetuese për çdo individ dhe subjekt juridik pa diskriminim me bazë moshe, kombësie, kapaciteti ligjor, gjinie apo etnie; 3) Regjistrimi i OSHC-ve nuk është i detyrueshëm dhe në rastet kur OSHC-të vendosin të regjistrohen, rregullat dhe procedurat e regjistrimit janë të vendosura e të parashikuara qartësisht në Ligj. Procesi i regjistrimit të OSHC-ve është i centralizuar dhe regjistrimi mund të bëhen vetëm në Gykatën e Shkallës së Parë në Tiranë; 4) Kuadri ligjor është shumë tolerant për krijimin e rrjeteve si brenda ashtu edhe jashtë vendit pa njoftim paraprak. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Decentralizim i procesit të regjistrimit të OSHC-ve.
	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Çdo person fizik apo juridikë mund të formojë shoqata, fondacione apo forma të tjera organizimesh jo-fitimprurëse, jo-qeveritare offline apo online. 2) Personat fizikë dhe juridikë nuk sanksionohen për mos-regjistrimin e organizatave të tyre. 3) Regjistrimi është me të vërtetë i arritshëm brenda afateve të përcaktuara me ligji; autoritetet vendosin mbi rastet në mënyrë jo-subjektive dhe apolitike. 4) Individët dhe OSHC-të mund të formojnë dhe të marrin pjesë në rrjete dhe koalicione, brenda dhe jashtë vendit të tyre. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e OSHC-ve dhe regjistrimi i OSHC-ve nuk mund të kryhet online; 2) Nuk aplikohen sanksione për OSHC-të e paregjistruara. Regjistrimi në Tiranë konsiderohet si një barrierë për OSHC-të të cilat e kanë qendrën në rrethe për shkak të kostove dhe kohës shtesë që nevojiten; 3) Procesi i regjistrimit është i thjeshtë, duke lejuar kështu një regjistrim të drejtë të OSHC-ve; 4) Pjesëmarrja e individëve në organizata formale e joformale është e lehtë dhe praktikisht, individët dhe OSHC-të mund të marrin pjesë në rrjetëzime dhe koalicione brenda dhe jashtë vendit të tyre. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nevojiten të dhëna zyrtare për numrin e OSHC-ve të regjistruara.

56

Në këtë sesion, tabelat mbi 12 standartet kryesore dhe 5 standartet e tjera të monitoruara për Shqipërinë janë me ngjyrë rozë. Gjetjet dhe rekomandimet e standarteve të tjera që nuk janë monitoruar për vitin 2014 bazohen në Raportin e Matricës së Monitorimit 2013.

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën – fusha 1.1: Liria e organizimit

INDIKATORËT		GJETJET		REKOMANDIMET PËR STANDARTET
STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT 2. OSHC-të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të pajustificuara të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme	Legjislacioni: 1) Kuadri ligjor ofron garancitë kundër ndërhyrjes së shtetit në çështjet e brendshme të shoqatave, fondacioneve apo llojeve të tjera të subjekteve jo-fitimprurëse. 2) Shteti siguron mbrojtje nga ndërhyrjet e palëve të treta. 3) Raportimi financiar (duke përfshirë rregulloret e pasurimit të parave) dhe rregullat e kontabilitetit konsiderojnë natyrën specifike të OSHC-ve dhe janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të saj. 4) Sanksionet për shkeljen e kërkesave ligjore duhet të bazohen në legjislacionin në fuqi dhe të ndjekin parimin e proporcionalitetit. 5) Kufizimet dhe rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen plotësojnë standardet e ligjeve ndërkombëtare dhe janë të bazuara në kriteret objektive të cilat kufizojnë vendimmarrjen arbitrare.	Legjislacioni: 1) Kuadri ligjor garanton të drejtën e OSHC-ve për të rregulluar strukturën e tyre të brendshme dhe procedurat operative pa ndërhyrje të pajustificuar të shtetit në qeverisjen dhe aktivitetet e tyre. 2) Raportimi financiar dhe rregullat e kontabilitetit nuk marrin në konsideratë natyrën specifike të OSHC-ve dhe nuk janë në proporcion me madhësinë e organizatës dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të saj. 3) Detyrat mbi organet vendim-marrëse dhe organin ekzekutiv janë e vazhdueshme dhe i ngarkojnë këto organe me përgjegjësi për të siguruar që organizatat partnere dhe ato që sigurojnë financim, shërbime dhe mbështetje materiale nuk përdoren apo manipulohen për qëllime terroriste dhe pasurim parash; 4) Rregullat për shpërbërjen dhe mbylljen janë të përshkruara qartësisht në ligjin për regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse dhe kufizojnë vendimmarrjen arbitrare.	Legjislacioni: 1) Aprovimi i formave të vecanta të raportimit dhe rregullave të kontabilitetit të përshtatshme për OSHC-të, të cilat marrin në konsideratë natyrën specifike të OSHC-ve, madhësinë dhe llojin / qëllimin e aktiviteteve të tyre. 2) Qartësimi i detyrave dhe përgjegjësi të organeve vendimmarrëse dhe drejtuese të OSHC-ve në lidhje me pasurimin e parave dhe financimin e terrorizmit në kuadrin ligjor dhe rregullator për OJF-të.	Praktika: 1) Sanksionet duhet të jenë në proporcion me karakterin specifik të OSHC-ve dhe llojin e shkeljes; 2) Trajtime për inspektorët tatimorë që janë të ngarkuar për mbikqyrjen e OJF-ve.
STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT 3. OSHC-të marrin dhe sigurojnë të ardhura financiare nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre.	Legjislacioni: 1) Legjislacioni lejon OSHC-të të angazhohen në aktivitetet ekonomike. 2) OSHC-të lejohen të marrin fonde të huaja. 3) OSHC-të lejohen të marrin fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera.	Legjislacioni: 1) Ligji mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse i lejon OSHC-të të përfihnen në aktivitetet ekonomike. Në amendimin e fundit të ligjit mbi OJF-të ka një sqarim të "aktivitetit ekonomik" nga OSHC-të; 2) Kuadri ligjor lejon OSHC-të të gjenerojnë fonde nga detyrimet, kur ka të tilla, grante dhe dhurime të ofruara nga subjekte publike apo private, vendase apo të huaja, si edhe të ardhurat nga aktiviteti ekonomik dhe asetet në pronësi të organizatës jo-fitimprurëse.	Legjislacioni: 1) Autoritetet shtetërore duhet t'u ofrojnë OSHC-ve udhëzime për të lehtësuar procesin e përfshirjes së tyre në aktivitetet ekonomike.	Praktika: 1) Ka një rritje të numrit të OSHC-ve të intervistuar (73% e OSHC-ve) që deklarojnë se nuk ka praktika të ndërhyrjes së shtetit në qeverisjen e tyre të brendshme; 2) Nuk ka praktika të mbikqyrjes okupuese nga ana e shtetit, të evidentuara nga OSHC-të e intervistuar (81% e OSHC-ve); 3) Nuk është evidentuar ndonjë rast i aplikimit të sanksioneve; me mbikqyrjen e OSHC-ve.

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën – fusha 1.1: Liria e organizimit

INDIKATORËT		GJETJET		REKOMANDIMET PËR STANDARTET
STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT 3. OSHC-të marrin dhe sigurojnë të ardhura financiare nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur aktivitetin e tyre.	Legjislacioni: 1) Legjislacioni lejon OSHC-të të angazhohen në aktivitetet ekonomike. 2) OSHC-të lejohen të marrin fonde të huaja. 3) OSHC-të lejohen të marrin fonde nga individët, korporatat dhe burime të tjera.	Legjislacioni: 1) Ligji mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse i lejon OSHC-të të përfihnen në aktivitetet ekonomike. Në amendimin e fundit të ligjit mbi OJF-të ka një sqarim të "aktivitetit ekonomik" nga OSHC-të; 2) Kuadri ligjor lejon OSHC-të të gjenerojnë fonde nga detyrimet, kur ka të tilla, grante dhe dhurime të ofruara nga subjekte publike apo private, vendase apo të huaja, si edhe të ardhurat nga aktiviteti ekonomik dhe asetet në pronësi të organizatës jo-fitimprurëse.	Legjislacioni: 1) Autoritetet shtetërore duhet t'u ofrojnë OSHC-ve udhëzime për të lehtësuar procesin e përfshirjes së tyre në aktivitetet ekonomike.	Praktika: 1) Sanksionet duhet të jenë në proporcion me karakterin specifik të OSHC-ve dhe llojin e shkeljes; 2) Trajtime për inspektorët tatimorë që janë të ngarkuar për mbikqyrjen e OJF-ve.

<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Legjislacioni për OSHC-të që angazhohen në aktivitete ekonomike zbatohet dhe nuk përbën barrë për OSHC-të. Nuk ka kufizime (p.sh. barrë administrative ose financiare, përmirimit, apo kanalizim të fondeve të tilla nëpërmjet organeve të veçanta) për OSHC-të për të marrë fonde të huaja. Marrja e financimit nga individët, korporatat dhe burime të tjera është e lehtë, efektive dhe pa ndonjë kosto të panevojshme apo barrë administrative. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Raportimi i aktiviteteve ekonomike dhe jo ekonomike me të njëjtin format është jo efektiv dhe i rënduar për OSHC-të; Legjislacioni nuk shfaq ndonjë barrierë ligjore lidhur me aksesin në fonde qofshin këto me origjinë vendase apo të huaja; Nuk ka përfitime apo lehtësira tatimore për dhurimet individuale dhe korporative që do të mund të rrisnin marrjen e fondeve nga individët, korporatat dhe burime të tjera private. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Aplikimi i formave të ndara për raportimin e aktiviteteve ekonomike dhe jo ekonomike të OSHC-ve nga autoritetet tatimore; Sigurimi i incentivave tatimore për individët dhe korporatat që ofrojnë fonde për OSHC-të.
<p>FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE Nën –fusha 1.2: Lirë e tjera</p>		
<p>Parimi: Lirë e organizimit dhe të sipërhyes janë të garantuara për të gjithë.</p>		
<p>STANDARTET <small>HAPAT E MATRES SË PROGRESIT</small></p> <p>1. Përfaqësuesit e OSHC-ve individualisht apo përmes organizatave të tyre, gëzojnë lirinë e organizimeve paqësore.</p>	<p>INDIKATORËT</p> <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kuadri ligjor është i bazuar në standardet ndërkombëtare dhe siguron të drejtën e lirisë së organizimit për të gjithë pa asnjë diskriminim. Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë mbledhjet spontane, simultane. Ushtimi i së drejtës nuk është subjekt për autorizim paraprak nga autoritetet, por më e shumta për një procedurë njoftimi Çdo kufizim i së drejtës bazuar në ligj dhe lëshuar nga autoriteti rregullator mund të apelohej nga organizatorët. 	<p>GJETJET</p> <p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kuadri ligjor garanton të drejtën e lirisë së organizimeve paqësore të sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë dhe e specifikuar në ligjin mbi Tubimet; Ligjet i njohin dhe nuk i kufizojnë mbledhjet spontane, simultane; Ligji rregullon procedurat e njoftimit paraprak në rastet kur mbledhja organizohet në hapësira publike apo në rrugë. Kur organizimet planifikohen në hapësira të hapura publike ato mund të organizohen edhe pa lajmëruar paraprakisht; Ligji parashikon të drejtën e apelimit administrativ nga organizatorët.
<p>REKOMANDIMET PËR STANDARTET</p> <p>Legjislacioni:</p>		

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën –fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi: Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste të shkeljes së lirisë së tubimit, dhe çdo grup njerëzish mund të mbledhet në vendin dhe kohën e dëshiruar, në përputhje me dispozitat ligjore. 2) Kufizimet janë të justifikuara me shpjegimin e arsyes për çdo kufizim, i cili i komunikohet menjëherë me shkrim organizatorit për të garantuar mundësinë e apelimit. 3) Mbledhjet simultane, spontane mund të kryhen, dhe shteti lehtëson dhe mbrohet grupet për të ushtruar të drejtën e tyre kundër njerëzve të cilët synojnë për të parandaluar ose prishur mbledhjen. 4) Ka raste të lirisë së mbledhjes të praktikuar nga OSHC-të (individualisht ose nëpërmjet organizatave të tyre) pa autorizim paraprak, kur njoftimi nevojitet ai dorëzohet në një periudhë të shkurtër kohe dhe nuk kufizon mundësinë për të organizuar mbledhjen. 5) Nuk ka përdorim të tepruar të forcës të ushtruar nga organet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë këtu edhe ndalimin apo dënimin e organizatorëve dhe pjesëmarrësve. 6) Media duhet të ketë qasje sa më të madhe nëpër mbledhje. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Perceptimi dhe eksperimentat e OSHC-ve në lidhje me ushtrimin e të drejtës së tyre për t'u mbledhur është përmirësuar; 2) 88% e OSHC-ve deklarojnë se liria e organizimit respektohet; 3) 32% e OSHC-ve deklarojnë se ka raste të organizimeve spontane, simultane pa autorizim paraprak të shkruar; 4) 91% e OSHC-ve deklarojnë se nuk ka përdorim të tepruar të forcës nga organet e zbatimit të ligjit gjatë organizimeve. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kërkesat për marrjen e lejes për organizimet spontane duhet simultane duhet të reduktohen në njoftim në vend të marrjes së autorizimit nga shefi i komisarariatit.

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën –fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi: Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
2. Përfaqësuesit e OSHC, individualisht apo përmes organizatave, gëzojnë lirinë e shprehjes.	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Korniza ligjore siguron lirinë e shprehjes për të gjithë. 2) Kufizimet, të tilla si kufizime të të folurit me urrëjtje, të imponuara nga legjislacioni janë të përshkruara qartë dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. 3) Shpifja përbën më tepër një kundërvajtje se sa pjesë e kodit penal. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shqipëria ofron sigurinë kushtetuese dhe ligjore të së drejtës së qytetarëve për t'u shprehur lirisht; 2) Kurzime të tilla si kufizimet e të folurit me urrëjtje të imponuara nga legjislacioni, janë të përshkruara qartë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; 3) Shpifja rregullohet në Kodin Penal, pavarësisht përplekëve në vitin 2012 për ta përfshirë atë në kodin civil. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shpifja në shkrimet dhe fjalime duhet të përfshihet në Kodin Civil në vend që të jetë pjesë e Kodit Penal

	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përfaqësuesit e OSHC, sidomos organizatave për të drejtat e njeriut dhe ëatch dog, gëzojnë të drejtën e lirisë së shprehjes në çështje që ata mbështesin dhe ndaj të cilave janë kritikë. 2) Nuk ka raste të shkeljes së të drejtës së lirisë së shprehjes për të gjithë. 3) Nuk ka raste ku individë, duke përfshirë përfaqësues të OSHC-ve do të persekutoheshin për fjalime kritike, në publik apo private. 4) Nuk ka asnjë sanksion për fjalimin kritik, në publik apo privat, sipas kodit penal. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Në praktikë OSHC-të ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes pa ndonjë ndërhyrje, duke qënë se ato lejojnë të organizojnë seminare, konferenca apo evente të tjera publike për të diskutuar çështje të ndryshme, për të marrë pjesë dhe për të shprehur këndvështrimet dhe opinionet e tyre në median e shkruar, elektronike dhe sociale, edhe në rastet e kritikave ndaj qeverisë.
--	---	--

FUSHA 1: GARANCITË THEMELORE JURIDIKE

Nën –fusha 1.2: Liritë e tjera

Parimi: Liritë e organizimit dhe të shprehjes janë të garantuara për të gjithë.

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
<p>3. Përfaqësuesit e shoqërisë civile, individualisht dhe përmes organizatave të tyre, kanë të drejtën për të marrë dhe ndarë informacion të sigurtë përmes çdo media</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Kuadri ligjor ofron mundësinë për të komunikuar nëpërmjet dhe për të patur akses në çfarëdo burim informacioni, duke përfshirë Internetin dhe Teknologjinë e Komunikimit të Informacionit (ICT); nëse ka kufizime ligjore këto janë të rralla, të kufizuara dhe në bazë të ligjeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. 2) Kuadri ligjor ndalon monitorimin pajustifikuar të kanaleve të komunikimit, duke përfshirë Internetin dhe ICT, ose mbledhjen e informacionit të përdoruesit nga ana e autoriteteve. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni Shqiptar përmbush kërkesat kryesore në mënyrë që të lehtësojë dhe mbështesë implementimin dhe përmirësimin e teknologjive, shërbimeve dhe rregulloreve të reja në sektorin shqiptar të TIK; 2) Shqipëria ende vuan nga përqindja e ulët e ndërfutjes së linjave dhe internetit, përqindje e ulët e zotërimit të kompjuterave, kostove të larta të internetit dhe aksesit e shërbimeve nëpërmjet celularëve, nivel i ulët i ndërgjegjësimit për përfitimet e përdorimit të TIK, hendeku dixhital midis zonave urbane e rurale dhe krahasuar me vende të tjera në Evropë, nivel i ulët i subvencioneve shtetërore dhe mungesë politikash për t'i mbështetur ato. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përmirësim i shtrirjes së rrjetit edhe në zonat rurale; 2) Rishikimi i ligjit mbi koston e internetit dhe shërbimet e aksesin në celularë; 3) Politika publike për zhvillimin e TIK.
<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nuk ka raste në praktikë, ku janë vendosur kufizime mbi qasjen e çfarëdo burimi informacioni, përfshirë internetin apo ICT. 2) Interneti është gjerësisht i arritshëm dhe i përballueshëm. 3) Nuk ka asnjë praktikë apo raste monitorimi të pajustifikuar nga ana e autoriteteve, të kanaleve të komunikimit duke përfshirë internetin apo ICT, ose mbledhjes së informacionit të përdoruesit. 4) Nuk ka raste të ngacmimit të anëtarëve të grupeve të rrjeteve sociale nga ana e policisë. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Në praktikë nuk ka raste ku të jenë imponuar kufizime në aksesimin e ndonjë burimi informacioni, përfshirë edhe internetin apo TIK; 2) Interneti është gjerësisht i aksesueshëm dhe i përballueshëm nga OSHC-të në zonat rurale dhe në qytetet e mëdha, ndërkohë që OSHC-të në zonat e thella rurale, kanë vështirësi në aksesimin e internetit dhe pagesën gjë që ndikon në ekzistencën e tyre dhe në veprimtarinë e tyre efektive; 3) Nuk ka praktika apo raste të monitorimit të pajustifikuar të kanaleve të komunikimit nga autoritetet, duke përfshirë internetin apo TIK, apo mbledhjen e informacionit të përdoruesve; 4) Nuk ka raste të ngacmimit të anëtarëve të grupeve e rrjeteve sociale nga ana e policisë. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Nevojitet shtrirja e internetit në zonat rurale; 2) Çmime të përballueshme për OSHC-të e vogla dhe ato në zonat rurale. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përmirësim i shtrirjes së rrjetit edhe në zonat rurale; 2) Rishikimi i ligjit mbi koston e internetit dhe shërbimet e aksesin në celularë; 3) Politika publike për zhvillimin e TIK.

FUSHA 2 : KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.
Nënfusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.
Parimi: OSHC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
1. Përfitimet tatimore janë të vlefshme për burime të ardhurash të ndryshme të OSHC-ve	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji parashikon trajtim tatimor falas për të gjithë grantet dhe donacionet që mbështesin aktivitetin jo-ftimprurës të OSHC-ve. Ligji siguron përfitime tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve. Ligji siguron përfitime tatimore për investimet pasive të OSHC-ve. Ligji lejon krijimin dhe siguron përfitime tatimore për Fondet e Dhurimeve të Kushtëzuara. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nuk është raportuar asnjë taksë mbi grantet direkte ose indirekte (e fshehur). Përfitimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OSHC-ve janë efektive dhe mbështesin funksionimin e OSHC-ve. Investimet pasive janë shfrytëzuar nga OSHC-të dhe nuk janë aplikuar sanksione për të tilla investime. Dhurimet e kushtëzuara që mundësojnë glenerimin e të ardhurave (Endoements) janë krijuar pa vështirësi të mëdha procedurale dhe vepronjë lirishit, pa ndonjë barrë administrative apo kosto të lartë financiare. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji mbi OJF-të, amenduar me ligjin nr. 92/2013, siguron se të ardhurat nga të gjitha dhurimet, grantet, depozitat bankare dhe pagesat e anëtarësimit, janë përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat; Ligji i ri mbi TVSH, ligji nr. 92/2014 qartëson përjashtimin e granteve nga skema e TVSH; Aktivitetet ekonomike nuk janë subjekt i taksës mbi të ardhurat, përveç rasteve kur këto të ardhura nuk përdoren për aktivitetet për të cilat organizata është regjistruar; Aktivitetet ekonomike të OSHC-ve të quajtura "aktivitete me interes publik" janë të përjashtuara nga TVSH; Vetëm interesi bankar (një nga format e investimit pasiv) përjashtohet nga taksat mbi të ardhurat; Nuk ka një kuadër ligjor mbi dhurimet e kushtëzuara. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të ardhurat e OSHC-ve nga burimet vendase vazhdojnë të mbeten në nivele të ulëta, duke mos ofruar një kontribut domethënës në qëndrueshmërinë financiare të OSHC-ve; Sektori i OSHC-ve trajtohet në të njëjtën mënyrë si ofruesit e tjerë; Ka një mungesë informacioni dhe kuptimi mes OSHC-ve lidhur me trajtimin fiskal; Dhurimet e kushtëzuara nuk rregullohen me ligji, por në praktikë ato mund të zbatohen lirishit pa procedura të rënduara. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rregullim ligjor për themelimin dhe sigurimin e përfitimeve tatimore për dhurimet e kushtëzuara dhe gjithë format e investimeve pasive. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Organizimi i sesioneve të informimit për OSHC-të mbi ndryshimet ligjore lidhur me trajtimin fiskal të granteve, aktivitetin ekonomik dhe burimet e tjera të financimit; Promovimi i dhurimeve të kushtëzuara si burim të ardhurash për OSHC-të.

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.
Nënfusha 2.1: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC-të dhe donatorët e tyre.
Parimi: OSHC-të dhe donatorët gëzojnë trajtim të favorshëm tatimor

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
2. Ofrohen lehtësira për të nxitur dhurimet nga individë dhe korporata.	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligji parashikon zbritje nga taksat për dhurime individuale apo nga korporatat për OSHC-të. Ka kërkesa/ kushte të qarta për marrjen e dhurimeve për të cilat ka ulje nga taksat dhe këto përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh në dobi të publikut. Politikat shtetërore në lidhje me përgjegjshmërinë sociale (CSR) marrin në konsideratë nevojat e OSHC-ve dhe i përfshijnë ato në programet e tyre. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Bazuar në Ligjin e Sponsorizimit, donatorë konsiderohen vetëm individët dhe kompanitë e biznesit që kanë cilësinë e "shitësit", duke përjashtuar në këtë mënyrë punonjësit; Niveli i zbritjeve tatimore nuk është mjaftueshëm inkurajues për dhurimet që individët dhe korporatat i bëjnë OSHC-ve; Shqipëria ka hartuar Planin Kombëtar të Veprimit dhe treguesit përkatës mbi përgjegjshmërinë sociale të korporatave (PSK), janë krijuar Forumet me grupe të ndryshme interesi PSK dhe përshtatjen e standardeve ISO 260000. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rishikimi i ligjit mbi sponsorizimin për më tepër stimuj/lehtësira për dhurimet, si edhe lehtësimi i procedurave për rimbursimin; Zhvillimi i përgjegjshmërisë sociale të korporatave përmes politikave publike kombëtare.

	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ekziston një procedurë funksionale për të kërkuar zbritje taksash për dhurime individuale apo të korporatave. 2) Organizatat e Shoqërisë Civile janë partnerë me shtetin në promovimin e CSR. 3) OSHC-të që punojnë në fushat kryesore të interesit publik, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe organizatat mbikëqyrëse, në mënyrë efektive përfitojnë dhurime për të cilat aplikohet ulje taksash. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedurat për të kërkuar zbritje taksash nuk janë funksionale dhe nuk inkurajojnë dhurimet individuale dhe të korporatave; 2) OSHC-të po luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e PSK; 3) Nuk ka ulje specifike taksash për këto lloj organizatash. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Krijimi i stimujve që do të ulin barrën e taksave për ndërmarrjet në mënyrë që ato të kryejnë aktivitete filantropike; 2) Konsultimi i OSHC-ve mbi promovimin e PSK; 3) Njohja e dhurimeve (bërja e tyre publike dhe e dukshme).
--	--	--	---

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nën-fusha 2.2 Mbeshtetja e shtetit

Parimi Mbeshtetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjegjshme

STANDARTET MAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
<p>1. Financimi publik është i vlefshëm për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen e projekteve dhe bashkë-financimin e BE dhe granteve të tjera.</p>	<p>Legjislati:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ka një ligj apo politikë kombëtare (dokument), që rregullon mbështetjen shtetërore për zhvillimin institucional të OSHC-ve, mbështetjen për projektet dhe bashkë-financimin e projekteve të financuara nga BE. 2) Ekziston një mekanizëm në nivel kombëtar për shpërndarjen e fondeve publike për OSHC-të. 3) Fondet publike për OSHC-të janë planifikuar në mënyrë të qartë në buxhetin e shtetit. 4) Ka procedura të qarta për pjesëmarrjen e OSHC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik. 	<p>Legjislati:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Mbeshtetja e shtetit për zhvillimin institucional të OSHC-ve dhe mbështetja e projekteve është përcaktuar në ligjin për Themelimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC); 2) Fondet sigurohen vetëm nëpërmjet mekanizmit kombëtar që ka mandat për shpërndarjen e fondeve publike tek OSHC - të dhe kjo është (AMSHC); 3) AMSHC po punon për krijimin e një Fondi të Përbashkët me donator të tjerë, për mbështetjen e projekteve të përbashkëta të një rëndësie strategjike për vendin. 20% e buxhetit vjetor të AMSHC do t'i dedikohet Fondit të Përbashkët; 4) Një kontribut prej 2,2% e qarkullimit vjetor nga Llotaria Kombëtare i dedikohet "çështjeve të mira", pa targetuar specifikisht OSHC-të. OSHC-të mund të konkurojnë për këtë fond. 	<p>Legjislati:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Përgatitja dhe aplikimi i procedurave për pjesëmarrjen e OSHC-ve në të gjitha fazat e ciklit të financimit publik, duke përfshirë planifikimin dhe monitorimin e shpërndarjes së financimit publik; 2) Krijimi i një linje specifike buxheti në buxhetin e AMSHC dedikuar mbështetjes institucionale të OSHC-ve; 3) Përfshirja e përfaqësuesve të OSHC-ve në Bordin e Çështjeve të Mira të Llotarisë Kombëtare.
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Fondet publike në dispozicion u përgjigjen nevojave të sektorit të OSHC-ve. 2) Ekzistojnë organe qeveritare me një mandat të qartë për shpërndarjen dhe / ose monitorimin e shpërndarjes së fondeve shtetërore. 3) Financimi është i parashikueshëm, jo i prerë në mënyrë drastike nga njëri vit në tjetrin, dhe shuma e buxhetit për OSHC është lehtësisht e identifikueshme. 4) Pjesëmarrja e OSHC-ve në ciklin e financimit publik është transparente dhe kuptimplote. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Financimet publike nuk janë të vlefshme për zhvillimin institucional dhe programatik të OSHC-ve. 64% e OSHC-ve të intervistuar deklaruan se fondet publike nuk u përgjigjen aspak nevojave të tyre; 2) Fushat prioritare të financimit të AMSHC janë në linjë me prioritetet strategjike të qeverisë dhe nuk marrin në konsideratë nevojat dhe prioritetet e OSHC-ve. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) AMSHC duhet të realizojë konsultime të rregullta me OSHC-të për të vendosur fushat prioritare të financimit publik në përgjigje të nevojave dhe prioritetëve të OSHC-ve.

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nën-Fusha 2.2.: Mbështetja e shtetit

STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
2. Financimi publik jepet në një mënyrë të paracaktuar dhe transparente	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike është transparente dhe ligjrisht detyruese për palët. 2) Kriteret për përzgjedhje janë të qarta dhe të publikuara paraprakisht. 3) Ekzistojnë procedura të qarta që adresojnë çështjet e konfliktit të interesit në vendimmarrje. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Informacione lidhur me procedurat për financim dhe informacioni mbi projektet e financuara është në dispozicion të publikut. 2) Organet shtetërore ndjekin procedurën dhe e aplikojnë atë në një mënyrë të harmonizuar. 3) Kërkesat e aplikimit nuk përbëjnë barrë për OSHC-të. 4) Vendimet mbi tenderat konsiderohen të drejta dhe konfliktet e interesit janë shpallur paraprakisht. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e financimeve publike sic përsëritet në ligjin për themelimin e AMSHC dhe në rregulloren e saj të brendshme, është transparente dhe ligjrisht detyruese; 2) Lista e kritereve publikohet gjatë lancimit të thirrjes për propozime; 3) Procedurat që adresojnë çështje të konfliktit të interesit në vendimmarrje janë të përsëritura në ligjin e AMSHC, por në praktikë nuk aplikohen ashtu siç duhet. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) AMSHC ka zhvilluar një dialog më të hapur me sektorin e shoqërisë civile, megjithëse transparenca dhe përgjegjësia në shpërndarjen e financimit dhe konflikti i interesit në agjenci vazhdojnë të mbeten problematike. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Miratimi i procedurave të qarta për adresimin e çështjeve të konfliktit të interesit në vendimmarrjen e AMSHC. <ol style="list-style-type: none"> 1) Rritje e transparencës dhe përgjegjësisë së AMSHC në shpërndarjen e fondeve dhe programimit të përshtatshëm për t'u përgjigjur nevojave të s OSHC-ve; 2) Thjeshtëzimi i kërkesave të aplikimit dhe dokumentacionit të kërkuar nga AMSHC; 3) AMSHC duhet t'u kthejë përgjigje në formë të shkruar dhe në kohë OSHC-ve lidhur me arsyen e mospranimit të projekt-propozimeve të tyre.

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nën-fusha 2.2 Mbështetja e shtetit

STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
3. Ka një sistem të qartë të logaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit të financimeve publike	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike parashikon masa të qarta për logaridhënien, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. 2) Ka sanksione për OSHC-të që keqpërdorin fondet dhe ato janë në proporcion me shkëlqjen e procedurës. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Procedura për shpërndarjen e fondeve publike dhe sanksioneve janë të parashikuara në ligjin e AMSHC-së. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Zhvillimi i një rregulloreje me sistem të qartë përgjegjësie, monitorimi dhe vlerësimi.

<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Monitorimi kryhet vazhdimisht dhe në përputhje me indikatorët objektivë dhe të paracaktuar. 2) Vlerësimi i rregullit i efekteve / impaktit të fondeve publike kryhet nga organet shtetërore dhe është në dispozicion të publikut. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Monitorimi realizohet nga AMSHC gjatë implementimit të projektit, por pa standarde të konsoliduara; 2) Nuk realizohet vlerësimi i rregullit i efektit/impaktit të fondeve publike nga AMSHC. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Më tepër vlerësime mbi impaktin e projekteve.
<p>FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHIMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË. Nën-Fusha 2.2.: State support</p>		
<p>Parlmi Mbështetja e shtetit ndaj OSHC-ve jepet në një mënyrë transparente dhe përdoret në mënyrë të përgjeshme</p>		
<p>STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT 4. Ekziston mbështetja jo-financiare nga shteti</p>	<p>INDIKATORËT</p>	<p>REKOMANDIMET PËR STANDARTET</p>
<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Legjislacioni lejon autoritetet shtetërore të alokojnë mbështetje jo-financiare, si psh. pronë shtetërore, marrje me qera të hapësirës pa kompensim financiar (kohor), trajnime, konsultime dhe burime të tjera falas për OSHC-të. 2) Mbështetja jo-financiare ofrohet në bazë të proceseve të përcaktuara në mënyrë të qartë, duke u bazuar në kritere objektive dhe pa privilegjuar asnjë grup. 	<p>GIETJET</p>	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Zhvillimi i procedurave/udhëzimeve të qarta për mbështetjen jo-financiare të shtetit.
<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) OSHC përdorin mbështetje jo-financiare nga shteti. 2) OSHC trajtohen në mënyrë të barabartë ose përfitojnë më shumë mbështetje në krahasim me aktorët e tjerë, kur ofrojnë burime jo-financiare shtetërore; 3) Nuk ka raste të autoriteteve shtetërore që ofrojnë mbështetje jo-financiare vetëm për OSHC-të që nuk kritikojnë punën e tyre; ose e rasteve të privimit të mbështetjes për OSHC-të kritike; ose diskriminim tjetër bazuar në besnikërinë, përkatësinë politike ose terma të tjera të paligjshme. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) OSHC-të kërkojnë mbështetje jo-financiare nga ana e shtetit të tillë si: pronat shtetërore, dhënia e hapësirave pa kompensim financiar, trajnime, konsultime dhe burime të tjera falas për OSHC-të; 2) Ka raste, sidomos në nivel lokal kur një autoritet lokal ofron mbështetje jo-financiare, por këto janë raste sporadike; 3) AMSHC nuk ofron mbështetje jo-financiare për OSHC-të. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Rritja e mbështetjes jo-financiare për OSHC-të; 2) Rritje e rolit të AMSHC në sigurimin e mbështetjes jo-financiare për OSHC-të.

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nën-fusha 2.3: Burimet Njerëzore

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
1. OSHC-të trajtohen në një mënyrë të barabartë me punëdhënësit e tjerë	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> OSHC trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit të tjerë me ligj dhe politika. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nëse ka programe shtetërore për nxitje punësimi, OSHC-të trajtohen njësoj si të gjithë sektorët e tjerë. Ka statistika të rregullta mbi numrin e të punësuarve në sektorin jo-ftimprurës. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Legjislacioni Shqiptar lidhur me burimet njerëzore është i unifikuar për punonjësit dhe aplikohet pa trajtim të diferencuar për OSHC-të. Kuadri ligjor për sigurimet shoqërore në vend vazhdon të jetë problematik për OSHC-të lidhur me detyrimet për të paguar sigurimet për të paktën një punonjës, edhe në periudhat kur organizata nuk ka projekte në zbatim, nuk ka aktivitate dhe nuk ka fonde. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Politikat shtetërore duhet të dizajnohen për të promovuar dhe stimuluar punësimin në OSHC; Kuadri ligjor që vendos detyrime mbi OSHC-të për të paguar sigurime për të paktën një punonjës edhe në rastet kur OSHC nuk ka aktivitet, duhet të rishikohet, duke marrë në konsideratë natyrën specifike të OSHC-ve. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi i mekanizmave për mbledhjen e informacionit dhe statistikave kombëtare mbi numrin e punonjësve në sektorin e shoqërisë civile.

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nën-fusha 2.3: Burimet Njerëzore

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORËT	GIJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
2. Ekzistojnë politika dhe ligje që mundësojnë vullnetarizimin	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Legjislacioni stimulon vullnetarizimin dhe përfshin praktikë më të mira rregullative, duke lejuar në të njëjtën kohë për praktikë spontane vullnetarizimi. Ekzistojnë stimuj dhe programe të mbështetura nga shteti për zhvillimin dhe promovimin e vullnetarizimit. Ekzistojnë marrëdhënie kontraktuale të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe mbrojtje për vullnetarizimin e organizuar. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nxjtjet dhe programet janë transparente dhe lehtësisht të disponueshme nga OSHC-të dhe politika / dokumenti strategjik / ligji zbatohet plotësisht, monitorohet dhe vlerësohet periodikisht në mënyrë pjesëmarrëse. Procedurat administrative për organizatorët e aktiviteteve vullnetare ose vullnetarëve nuk janë të komplikuar dhe janë pa ndonjë kosto të panevojshme. Vullnetarizimi mund të bëhet në çfarëdo forme, nuk ka raste ankesash mbi kufizimeve ndaj vullnetarizimit. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Shqipëria nuk ka një ligj të veçantë për vullnetarizimin; Shteti vendos detyrime ligjore për deklarimin dhe regjistrimin në zyrën e punësimit dhe pagimin e sigurimeve për vullnetarët; përndryshe ka dënime të ashpura. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> 76% e OSHC-ve të intervistuar deklarojnë se nuk kanë informacion mbi programet e vullnetarizimit; Nuk ka raste të kufizimit të vullnetarizimit të raportuara. 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Miratimi i ligjit mbi Vullnetarizimin për rregullimin e marrëdhënieve mes OSHC-ve dhe vullnetarëve si edhe midis OSHC-ve dhe shtetit. <p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Rritje e shëmbimit të informacionit mes OSHC-ve për programet e vullnetarizimit dhe procedurat për organizimin e aktiviteteve vullnetare.

FUSHA 2: KUADRI PËR QËNDRUESHMËRINË DHE LEHTËSIRAT FINANCIARE PËR OJF-TË.

Nën-fusha 2.3: Burimet Njerëzore

INDIKATORËT		GJETJET		REKOMANDIMET PËR STANDARTET
Parimi: Politikat shtetërore dhe mjedisi ligjor stimulojnë dhe lehtësojnë punësimin, vullnetarizimin dhe angazhime të tjera me OSHC-të				
STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT 3. Sistemi arsimor promovon angazhimin qytetarë	Legjislacioni: 1) Arsimi joformal promovohet nëpërmjet politikave strategjive /ligjeve. 2) Subjekte të lidhura me shoqërinë civile janë të përfshira në programin zyrtar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.	Legjislacioni: 1) Edukimi jo-formal përkrahur në ligjin shqiptar në Edukimin Profesional, por nuk ka një strategji/politikë/ligji të fokusuar vetëm në edukimin jo-formal; 2) Mësimet e lidhura me angazhimin qytetar përfshihen në kurrikulën e arsimit fillor dhe të mesëm si edhe në nivelin universitar.	Legjislacioni: 1) Formulimi i politikave/strategjive dhe ligjeve mbi edukimin jo-formal.	Legjislacioni: 1) Formulimi i politikave/strategjive dhe ligjeve mbi edukimin jo-formal.
	Praktika: 1) Sistemi arsimor përfshin mundësi për angazhim qytetar në OSHC. 2) Ofrimi i arsimit jo-formal nga OSHC-të njihet.	Praktika: 1) Sistemi i edukimit nuk stimulon promovimin e angazhimit qytetar në OSHC; 2) OSHC-të janë të përfshira gjerësisht në edukimin jo-formal përmes ofrimit të trajnimeve dhe kurseve profesionale.	Practice: 1) Pajisja me stimuj nga ana e shtetit për përfshirjen strategjike të OSHC-ve në sistemin arsimor.	

FUSHA 3: MARRËDHËNIA QEVERI-OSHC

Nën-fusha 3.1: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

INDIKATORËT		GJETJET		REKOMANDIMET PËR STANDARTET
Parimi: Ka një përqsje strategjike për të vazhduar bashkëpunimin Shtet-OSHC dhe zhvillimin e OSHC-ve				
STANDARTET HAPAT E MATIES SE PROGRESIT 1. Shteti njih, përmes strategjive dhe politikave, rëndësni e zhvillimit të një bashkëpunimi me sektorin	Legjislacioni: 1) Ekzistojnë dokumenta strategjike që kanë të bëjnë me marrëdhëniet shtet-OSHC dhe zhvillimin e shoqërisë civile. 2) Dokumenti strategjik përfshin qëllimet dhe masat si dhe financimin në dispozicion dhe ndarje të qartë të përgjegjësi (plane veprimi përfshirë indikatorët). 3) Dokumenti strategjik përfshin masa që janë zhvilluar në konsultim me dhe / ose të rekomanduara nga OSHC-ve.	Legjislacioni: 1) Bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) është përmirësuar; 2) Rezoluta "Për Njohjen dhe Fuqizimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimit Demokratik të Vendlit", miratuar nga Kuvendi, është dokumenti i parë politik që njih dhe vendos angazhime konkrete lidhur me këtë gjë; 3) Drafti i Udhërrëfyesit të Politikave të Qeverisë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile që është përgatitur gjatë vitit 2014, me synim drejtimin e Qeverisë drejt vendimmarrjes efektive për përmirësimin e mjedisit për bashkëpunim me shoqërinë civile.	Legjislacioni: 1) Miratimi i draftit të Udhërrëfyesit të Politikave të Qeverisë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.	Legjislacioni: 1) Miratimi i draftit të Udhërrëfyesit të Politikave të Qeverisë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

FUSHA 3: MARRËDHËNIA QEVERI-OSHC

Nën-fusha 3.1: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORET	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
	Parimi: Ka një përfaqje strategjike për të vazhduar bashkëpunimin Shtet-OSHC dhe zhvillimin e OSHC-ve		
	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> OSHC nga fusha të ndryshme me interes marrin pjesë rregullisht në të gjitha fazat e zbatimit strategjik të zhvillimit të dokumentit, dhe vlerësimin. Ka shumë shembuj që tregojnë se bashkëpunimi mes shtetit dhe OSHC-ve dhe zhvillimin e shoqërisë civile është përmirësuar dhe zbatohet në përputhje me ose përtej masave të parashikuara në dokumentin strategjik. Zbatimi i dokumentit strategjik është monitoruar, vlerësuar dhe rishikuar periodikisht. Politikat shtetërore për bashkëpunim midis shtetit dhe OSHC-ve dhe zhvillimin e shoqërisë civile janë të bazuara në të dhënat e besueshme të mblledhura nga statistikat kombëtare duke marrë parasysh larminë e sektorit. 	<p>Praktika:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ka një rritje të bashkëpunimit dhe gatishmërisë në institucionet shtetërore dhe OSHC-të për dialogun OSHC-shtet për diskutimin dhe propozimin e strategjive dhe politikave të shoqërisë civile. 43% e OSHC-ve kanë deklaruar se bashkëpunimi midis shtetit dhe OSHC-ve është përmirësuar; 	<p>Practice:</p> <ol style="list-style-type: none"> Zbatimi në praktikë i dokumentave strategjike të përgatitur dhe miratuar në vitin 2014

FUSHA 3: MARRËDHËNIA QEVERI-OSHC

Nën-fusha 3.1: Kuadri dhe praktikat për bashkëpunim

STANDARTET HAPAT E MATJES SE PROGRESIT	INDIKATORET	GJETJET	REKOMANDIMET PËR STANDARTET
	Parimi: Ka një përfaqje strategjike për të vazhduar bashkëpunimin Shtet-OSHC dhe zhvillimin e OSHC-ve		
2. Shteti njih, përmes veprimtarisë së institucioneve të tij, rëndësinë e zhvillimit të sektorit dhe bashkëpunimit me të	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ekziston një institucion në nivel kombëtar ose mekanizëm me një mandat për të lehtësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile (p.sh., Njësia/Zyra për bashkëpunim; pikat e kontaktit në ministri, këshill). Ka dispozita të detyrueshme për përfshirjen e OSHC-ve në vendimet e marra nga institucioni kompetent apo mekanizmi (at). 	<p>Legislation</p> <ol style="list-style-type: none"> Është përgatitur projekt ligji mbi Kirjimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile; Parlamenti shqiptar ka miratuar "Rezolutën për Njohjen dhe Fuqizimin e Rolit të Shoqërisë Civile në Procesin e Zhvillimit Demokratik të Vendit". 	<p>Legjislacioni:</p> <ol style="list-style-type: none"> Miratimi i ligjit mbi Kirjimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile nga Kuvendi i Shqipërisë.

